

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



Sektori i agroturizmit në Shqipëri: Potencialet për zhvillim dhe nevojat financiare

Sektori i agroturizmit në Shqipëri: Potencialet për zhvillim dhe nevojat financiare

Përgatiti:

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

Creative Business Solutions (CBS)

Qershor 2019

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

PASQYRA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
QËLLIMI I STUDIMIT.....	7
1. AGROTURIZMI NË SHQIPËRI - NJË SEKTOR NË ZHVILLIM.....	8
1.1. Përmbledhje e sektorit të agroturizmit.....	8
1.2. Kuptimi i agroturizmit përkundrejt turizmit rural.....	12
2. NISMAT E QEVERISË PËR TË MBËSHTETUR ZHVILLIMIN E SEKTORIT	13
2.1. Strategjitë	13
2.2. Stimujt fiskalë dhe ligjorë.....	14
2.2.1. Stimujt fiskalë.....	14
2.2.2. Programet kombëtare dhe ndërkombëtare të granteve.....	14
2.2.3. Programi "100 fshatrat"	16
3. ZONAT ME MUNDËSI TË LARTA PËR ZHVILLIMIN E AGROTURIZMIT.....	19
3.1. Zonat me mundësi të larta zhvillimi	19
3.2. Modele suksesi.....	23
3.3. Hartëzimi i projekteve/iniciativave në fushën e agroturizmit	26
3.4. Modelimi i përvojës.....	28
3.5. Burimet e të ardhurave në agroturizëm	29
3.6. Konsiderata zhvillimore për të siguruar rritjen e qëndrueshme të agroturizmit... 	31
4. ANALIZA SWOT E SEKTORIT TË AGROTURIZMIT.....	32
5. NEVOJAT E FINANCIMIT TË AGROTURIZMIT	34
5.1. Produktet financiare ekzistuese për agroturizmin nga bankat dhe institucionet financiare në Shqipëri	34
5.2. Nevojat financiare të sektorit të agroturizmit.....	35
5.3. Risqet kryesore të lidhura me biznesin e agroturizmit	37
5.3.1. Strategjia e zbutjes së riskut.....	38
5.4. Potencialet për kreditim dhe produktet e propozuara të kredisë për sektorin e agroturizmit.....	39
6. REKOMANDIME PËR PROMOVIMIN E POTENCIALEVE TË AGROTURIZMI PËR FINANCIM	41
BURIMET E KONSULTUARA.....	42
SHTOJCAT	44

Shkurtime

AASF	Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar
ALCDF	Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Vendore
ALL	Lek
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
ATSH	Agjencia Telegrafike Shqiptare
BSH	Banka e Shqipërisë
D2T	Dibra: Shtigje dhe traditë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (e Kombeve të Bashkuara)
IF	Institucionet financiare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Global GAP	Praktikat e Mira Bujqësore Globale
QSH	Qeveria shqiptare
HACCP	Analiza e Rrezikut nëpërmjet Kontrollit të Pikave Kritike
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Paraantarësimit për Zhvillimin Rural
SNZHRB	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
KMP	Kreditë me Probleme
SKZHQT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit
IFP	Institucionet Financiare Partnerë
PPP	Partneriteti Publik-Privat
SWOT	Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë, Kërcënimet
FIT	Fondi për Investime dhe Financim në Turizëm
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një vend bujqësor me vendndodhje të jashtëzakonshme gjeografike, me peizazhe të mrekullueshme dhe mjaft e pasur në kulinari dhe gastronomi. Ndërturur me traditën e bukur të mikpritjes, Shqipëria ofron një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit. Ndërsa ky sektor është shfaqur të zhvillohet vetëm gjatë viteve të fundit, pritet që ai të rritet shpejt në të ardhmen e afërt dhe të mesme. Potenciali i pashfrytëzuar për zhvillimin e agroturizmit ekziston pothuajse në të gjithë vendin. Qarqet që premtojnë më shumë në ndërturjen e bujqësisë me atraksionet turistike janë Korça, Berati, Gjirokastra, Vlora, Shkodra, Kukësi dhe Dibra. Modelet më të zakonshme të agroturizmit janë restorantet "nga ferma në tryezë" me kapacitete të kufizuara akomodimi.

Agroturizmi trajtohet si një **sektor me prioritet të lartë** në programin e qeverisë. Shumica e strategjive të nivelit qendror dhe vendor e kanë konsideruar agroturizmin të rëndësishëm për bujqësinë dhe diversifikimin rural. Për sa u përket përpjekjeve të sektorit publik për të mbështetur agroturizmin, duket se nuk ka konflikt në role, por vetëm në koordinim. Shkëmbimi më i mirë i informacionit midis institucioneve publike do të sjellë përfitime të rëndësishme dhe rezultate më koherente të zhvillimit. Sinergjitë midis institucioneve publike dhe projekteve të donatorëve me fokus agroturizmin janë gjithashtu të rëndësishme në krijimin e efekteve më të mëdha të kombinuara. Një përkufizim më i mirë zyrtar i agroturizmit - sipas praktikave më të mira ndërkombëtare - do të përshpejtonte reformat e politikave dhe do të integronte më mirë financimin përmes granteve me zhvillimin e qëndrueshëm.

Sektori po përfiton nga disa **stimuj fiskalë** që përfshijnë reduktim të tvsh-së në 6%, tatim mbi të ardhurat e shoqërisë në 5% dhe përjashtim nga taksa e infrastrukturës për investimet. Këta stimuj fiskalë pritet të stimulojnë investimet dhe të zgjerojnë bazën e njësive të çertifikuara të agroturizmit. Sidoqoftë, njësitë ekzistuese dhe të reja të agroturizmit duhet të plotësojnë standartet dhe kriteret e çertifikimit në mënyrë që të përfitojnë nga skemat e mbështetjes. Ekzistojnë disa projekte zhvillimore donatorësh që synojnë të promovojnë agroturizmin, përfshirë edhe mbështetjen financiare. Këto projekte janë hartuar për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm rural në tërësi, duke krijuar të ardhura shtesë dhe punësim nëpërmjet agroturizmit. Megjithatë, shumica e skemave kombëtare të mbështetjes janë të përqendruara në nxitjen e ofertës, ndërkohë që është bërë pak për të krijuar kërkesë.

Në dy vitet e fundit janë implementuar në sektorin e agroturizmit rreth 10 milionë euro investime, stimuluar nga skema të ndryshme të granteve, siç janë skemat kombëtare të AZHBR-së dhe programi SARED. Mesatarisht 7 milion euro të tjera vlerësohet të jenë investuar nga vetë bizneset, bazuar në dëshmitë e tyre. Duke pasur parasysh që investimet specifike në agroturizëm nuk ekzistojnë më parë, këto kontribute, megjithëse të vogla, nuk janë të parëndësishme për më tepër kur ato përbëjnë një tendencë në rritje. Bazuar në të dhënat e përlllogaritura, mundësitë e investimeve të mbështetura me kapital nga programi IPARD, grantet kombëtare të AZHBR-së, programi "100 fshatrat" dhe programe të tjera mbështetëse, pritet të injektojnë një vlerë prej **50-70 milionë euro** investimetë reja në sektor gjatë 5-7 viteve të ardhshme.

Fondet e **IPARD-it** për zhvillimin e agroturizmit do të jenë të disponueshme deri në vitin 2023, ndërsa grantet e AZHBR-së pritet që të vazhdojnë çdo vit duke rritur mbështetjen për sektorin e agroturizmit. Programet mbështetëse të financimit janë një mundësi e shkëlqyer në treg për

bankat dhe institucionet financiare, pasi përfshirja e tyre në projektet e financimit të agroturizmit do të luante një rol vendimtar në rritjen e nivelit të përthithjes së fondeve. Programi "100 fshatrat" pritet të rrisë ofertën me 27 njësi të reja të agroturizmit dhe rreth 150 bujtina.

Pavarësisht potencialit, sektori përballlet me disa dobësi dhe **kufizime** që pengojnë rritjen. Ekziston një mungesë përvoja dhe një nivel i ulët i *aftësive menaxhuese* mes fermerëve dhe agrobizneseve që synojnë të shtojnë agroturizmin në aktivitetet e tyre. Niveli i ulët i arsimit në zonat rurale mund të rezultojë në mungesë të stafit të *kualifikuar* për ofrimin e shërbimeve të agroturizmit. Sektori vuan nga marketingu i dobët dhe promovimi i pamjaftueshëm. Infrastruktura *rrugore* dhe transporti i papërshtatshëm publik janë gjithashtu një pengesë, e cila kërkon ndërhyrje të menjëhershme me qëllim rritjen e kërkesës. Aksesin në financim është një nga pengesat kryesore, ndërsa paraqet gjithashtu një mundësi për institucionet financiare. Disa institucione financiare po shprehin interes duke investuar në produkte të specializuara. Sidoqoftë, kredidhënia për agroturizmin nuk trajtohet veçmas. Përkundrazi, ajo përfshihet në portofolin e bujqësisë, çka përbën një kufizim.

Në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe rreth 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 rretheve do të thotë 1200 sipërmarrje potenciale agroturizmi që presin mundësi investimi gjatë 5 deri në 7 vitet e ardhshme.

Disa nga nevojat e financimit lidhen me rindërtimin e godinave të vjetra, linjat e përpunimit në fermë dhe me aktivitetet e marketingut dhe certifikimit. **Kërkesa e qëndrueshme për investime, e kombinuar me mbështetjen e granteve dhe kredive për investime të reja**, është receta kryesore për zhvillimin e sektorit. Ndërkohë që tendenca për rritje pritet të vazhdojë, vetëm agrobizneset dhe bankierët inteligjentë ë cilët janë në gjendje të kuptojnë sistemin relativisht kompleks, do të jenë të suksesshëm në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme. Gjithashtu për programin AASF ekziston mundësia që të përshpejtojë aksesin ndaj njohurive dhe këshillimit teknik lidhur me ofertën dhe kërkesën, si dhe të lehtësojë investimet dhe rritjen e financimit për këtë sektor.

QËLLIMI I STUDIMIT

Bujqësia dhe turizmi janë ndër industritë që po zgjerohen me ritme më të shpejta në Shqipëri (INSTAT). Potenciali i agroturizmit për të krijuar marrëdhënie sinergjike midis këtyre dy sektorëve të rëndësishëm është pranuar gjerësisht nga planifikuesit dhe politikëbërësit. Qeveria Shqiptare (QSH) po i kushton vëmendje të veçantë agroturizmit duke ofruar stimuj fiskalë dhe financiarë dhe duke zhvilluar programe kombëtare për promovimin e sektorit.

Qëllimi i dokumentit është të inkurajojë Institucionet Financiare Partnere (IFP) që të përfshijnë ose ta përqendrojnë më shumë agroturizmin në portofolin e tyre të biznesit duke zhvilluar strategji të dedikuara financimi me produkte të përshtatura kredie për të plotësuar nevojat e financimit të sektorit.

Ky studim ofron informacione mbi potencialet e zhvillimit të agroturizmit në Shqipëri dhe nevojat e tij financiare për të mbështetur investimet. Më konkretisht, dokumenti hedh dritë mbi potencialet ekzistuese në sektorin e agroturizmit, duke u përqendruar në strategji të ndryshme publike, zhvillimet e fundit, stimujt fiskalë dhe financiarë, analizën SWOT të sektorit dhe një shtjellim të karakteristikave të kërkesës dhe ofertës për kapital në industrinë e agroturizmit për të ofruar disa rekomandime të dobishme për AASF-në dhe IFP-të.

Qasja teknike - Burimet e të dhënave dhe metodologjia

Studimi përdor një kombinim të burimeve të të dhënave parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë mbledhur nga bankat dhe përfaqësuesit e institucioneve mikrofinanciare, ekspertët e agroturizmit dhe sipërmarrësit e agroturizmit. Konsultimet me bankat dhe përfaqësuesit e institucioneve mikrofinanciare kanë qenë thelbësore për të kuptuar strategjitë e tyre të kredidhënies, produktet e financimit dhe nivelin e pranueshëm të riskut në sektorin e agroturizmit. Diskutimet me sipërmarrësit e agroturizmit ishin të rëndësishme për të kuptuar më mirë perceptimin e tyre për mjedisin e biznesit, çfarë perceptojnë ata si sfidat kryesore, si dhe për të vlerësuar planet e ardhshme për investime. Diskutimet me ekspertët e agroturizmit ndihmuan në marrjen e informacionit dhe në kuptimin e potencialit të pashfrytëzuar të sektorit.

Studimi u mbështet nga një përdorim i gjerë i të dhënave dhe informacionit dytësor, si p.sh. artikuj kërkimorë, raporte teknike dhe dokumente të ndryshme, strategji specifike sektoriale në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe burime dhe baza të dhënash të dobishme. Për një listë të detajuar të burimeve të të dhënave, lutemi të shihni faqen 38 në fund të dokumentit.

Raportet teknike dhe dokumentet u përdorën për të mbledhur të dhëna në lidhje me fondet potenciale të granteve, kreditë dhe tendencat e tjera. Strategjitë e zhvillimit specifike për sektorin u përdorën për të kuptuar rëndësinë që i është dhënë sektorit të agroturizmit nga qeveria qendrore, si dhe vizionin e saj për zhvillimin e tij. Strategjitë e zhvillimit për njësitë e qeverisjes vendore (NJQV-të) shërbyen për të kuptuar fokusin që i është dhënë agroturizmit nga bashkitë dhe qasjen e tyre ndaj zhvillimit të sektorit. Bazat e të dhënave të INSTAT-it u përdorën për të mbledhur të dhëna për numrin e fermave, madhësinë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve dhe grupeve të interesit u përdorën për të konfirmuar konkluzionet dhe/ose për të marrë informacion mbi tendencat ekzistuese të të dhënave.

1. AGROTURIZMI NË SHQIPËRI - NJË SEKTOR NË ZHVILLIM

1.1. PËRMBLEDHJE E SEKTORIT TË AGROTURIZMIT

Agroturizmi është një lloj hibrid i sistemit bujqësor që bashkon elementët e bujqësisë dhe turizmit për të krijuar ofertë për produktet dhe shërbimet bujqësore si dhe për të ofruar eksperiencë për turistët.

Ritmi i shpejtë i jetës në qytet dhe rritja e ndotjes së mjedisit po i shtyn banorët e qytetit drejt zonave rurale. Banorët e qyteteve të mëdha janë në kërkim të mjedisve ku ata mund të kalojnë kohën e çmuar në prani të familjes dhe miqve dhe të shijojnë veçantinë e natyrës. Turistët po largohen nga përvojat dhe programet turistike standarde, nga mjediset standarde nëpër hotele dhe nga të njëjtat atraksione dhe ekskursionet¹. Kjo tendencë përfaqëson një mundësi të shkëlqyer për sektorin e agroturizmit që po zhvillohet në Shqipëri.

Shkalla e rritjes së PBB-së në Shqipëri ishte mesatarisht 0,90 për qind nga viti 2005 deri në vitin 2019 dhe sektori i bujqësisë dhe ai i turizmit po përjetojnë një rritje të qëndrueshme në raport me ekonominë. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it mbi rritjen reale vjetore të PBB-së sipas sektorëve, bujqësia është rritur me një normë mesatare vjetore prej 2 për qind që nga viti 2012, ndërsa për të njëjtën periudhë sektori i turizmit është rritur me një normë mesatare vjetore prej 4,4 për qind (14,23 për qind në vitin 2017). Megjithatë, ka hapësirë të konsiderueshme për përshejtimin e rritjes dhe krijimin e vendeve të punës në ndërthurjen e këtyre dy sektorëve: *agroturizmi*.

Agroturizmi në Shqipëri është një sektor në zhvillim me potencial të madh. Vendndodhja gjeografike, peizazhet e jashtëzakonshme, tradita e kahershme e mikpritjes, kuzhina e pasur me shumë teknika tradicionale gatimi dhe produktet tradicionale e bëjnë Shqipërinë vendin e përsosur për një përvojë agroturizmi. Ekspertët ndërkombëtarë kanë konfirmuar se Shqipëria përmbush kriteret e nevojshme për t'u bërë një qendër e turizmit ekologjik evropian (Qirici dhe Theodhori, 2013). Deri tani, sektori i agroturizmit në Shqipëri është zhvilluar kryesisht jashtë fermave. Sipërmarrjet e reja nga ferma në tryezë aktualisht janë më të përhapura se bizneset në fermë. Këto sipërmarrje në të shumtën e rasteve nuk janë në pronësi të prodhuesve tradicionalë bujqësorë, por megjithatë kanë efekte pozitive thelbësore në të ardhurat e fermave.

Në fillim, agroturizmi përqendrohej në një numër të kufizuar qarqesh, kryesisht në krahinën (i) jugore të vendit (Vlora, Saranda dhe Gjirokastra); (ii) në Alpet e Veriut (Vermosh, Theth dhe Valbonë në qarqet e Shkodrës dhe Kukësit); dhe (iii) në qarkun e Korçës (Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq). Sidoqoftë, vitet e fundit biznese agroturizmi janë shfaqur në të gjithë Shqipërinë, me disa nga pikat më të mëdha të agroturizmit të ngritura përreth Tiranës, Durrësit dhe Lezhës. Ekziston një mungesë e përgjithshme e të dhënave zyrtare kur bëhet fjalë për Shqipërinë dhe asnjë institucion publik, përfshirë INSTAT-in apo Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), nuk po prodhon të dhëna rreth agroturizmit. Megjithatë, bazuar në përvojën praktike dhe konsultimet me grupet e interesit, në Shqipëri ekziston një numër prej më shumë se 300 bujtinash dhe 100 njësisish agroturizmi. Aktualisht, sipas informacionit nga MTM, ekzistojnë rreth 14 njësi të certifikuara të agroturizmit

¹ John Swarbrooke, universiteti "Metropolitan" i Mançesterit, Departamenti i Menaxhimit të Ushqimit dhe Turizmit


dhe të gjitha e kanë marrë çertifikimin në dy vitet e fundit. Shumica e bujtinave janë ngritur në veri të vendit (Theth, Valbonë); si dhe në qarkun e Korçës (Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq); Berat dhe Gjirokastër. Ndërsa njësitë e agroturizmit kanë një shpërndarje më normale, disa nga bizneset më të mëdha të agroturizmit gjenden në Tiranë, Durrës dhe Lezhë. Shumica e njësive të agroturizmit janë restorante të tipit "nga ferma në tryezë", me kapacitete të kufizuara akomodimi.

Bazuar në intervistat me ekspertë të përfaqësuesve të MBZHR-së dhe NjQV-ve, në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 qarqeve nënkupton një potencial prej 1,200 njësi të reja agroturizmi që presin mundësi investimi brenda 5 deri në 7 viteve të ardhshme.

Për më tepër, sipas INSTAT-it ekzistojnë 2,754 ferma që kanë ndërtesa të veçuara për veprimtari fitimprurëse që mund të shndërrohen në akomodim në përgjigje të kërkesës së mësipërme.

Stimujt fiskalë të ofruar nga qeveria, të kombinuar me programet e granteve që mbështesin këtë sektor, pritet të rritin investimet e agroturizmit në fermë dhe ta kthejnë agroturizmin në një sektor të rëndësishëm për ekonominë shqiptare. Gjatë vitit 2018, u hapën dhe u regjistruan në Shqipëri rreth 43 biznese të reja të agroturizmit dhe 34 bujtina (ATSH, 2018), çka është shenjë e interesit në rritje për investime në këtë sektor. Gjatë viteve 2014-2018 janë hapur 97 njësi të reja të agroturizmit dhe 113 bujtina, duke dhënë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e ofertës së agroturizmit dhe turizmit rural në Shqipëri.

Figura 1: Tendanca e njësive të reja të agroturizmit dhe bujtinave 2014-2018



Burimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare - ATSH

Interesi në rritje për të investuar në sektorin e agroturizmit në Shqipëri po vjen si nga investitorët kombëtarë, edhe nga ata ndërkombëtarë. Bizneset e konsoliduara në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe sipërmarrësit e rinj po mendojnë të investojnë në sektorin e agroturizmit. Ekziston gjithashtu një tendencë në rritje mes kantinave ekzistuese të verës për të konsideruar mundësinë e zgjerimit të biznesit të tyre duke investuar në agroturizëm, duke rezultuar në shtim të ofertës së biznesit.

Qeveria shqiptare e konsideron agroturizmin si një nga prioritetet kryesore për vitet e ardhshme dhe për të mbështetur këtë qëllim, ajo ka prezantuar programin "100 fshatrat". Qëllimi i këtij programi ambicioz është të mbështesë komunitetet vendore në përpjekjet e tyre për të ndërtuar

ekonomi të reja duke diversifikuar burimet e të ardhurave të tyre dhe duke gjeneruar mundësi punësimi.

Numri i turistëve që vizitojnë Shqipërinë po rritet me ritme të shpejta. Në vitin 2018, numri i turistëve që vizituan Shqipërinë ishte rreth 5,9 milionë, gjë e cila që tregon një rritje prej 15,8 përqind krahasuar me vitin 2017². Vendet e Evropës janë vendet kryesore të origjinës së turistëve që vizitojnë Shqipërinë, të cilët përbëjnë 92,4% të të gjithë turistëve. Në vitin 2018, në muze, kështjella dhe parqe kombëtare u regjistruan rreth 2 milionë vizita. Nuk ka të dhëna për numrin e turistëve që hyjnë në Shqipëri posaçërisht për përvojat e agroturizmit ose të turizmit rural, megjithatë, sipas Agjencisë së Udhëtimit të SHBA-së, rreth 8-10% e turistëve preferojnë aktivitete në natyrë, çka e çon tregun e mundshëm për agroturizëm në Shqipëri në rreth 500.000 turistë. Ekspertë dhe sipërmarrës të agroturizmit pranojnë se numri i turistëve që vizitojnë zonat rurale po rritet. Përveç vizitorëve të huaj, po rritet ndjeshëm kërkesa nga turizmi i brendshëm. Udhëtimet njëditore ose dyditore me familjen në zonat rurale po bëhen shumë të përhapura në Shqipëri. Bazuar në intervistat me bujtinat në zonat rurale, rreth 70% e vizitorëve në strukturat e agroturizmit janë vendas. Pavarësisht fluksit në rritje të turistëve vendas dhe të huaj në zonat rurale në Shqipëri, oferta e agroturizmit është larg përmbushjes së kërkesës si për nga sasia, edhe për nga cilësia. Turistët që vizitojnë atraksione natyrore në veri të Shqipërisë, si Parku Kombëtar i Lurës (ecje, alpinizëm, aktivitete rekreative në natyrë) shpesh flenë në çadra për shkak të ofertës së kufizuar të akomodimit (Intervistë - Llesh Doçi, bujtina Oxhaku i Doçit).

Aksesi i ulët në financim konsiderohet si një nga pengesat kryesore të rritjes për sektorin e agroturizmit. Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të agroturizmit kërkon përpjekje më të mëdha nga të gjithë aktorët në zinxhirët e vlerave në bujqësi dhe turizëm dhe më shumë fokus nga bankat dhe institucionet financiare në financimin e sektorit me produkte të dedikuara kredie. Investimet më të zakonshme që priten në të ardhmen janë ato që përqendrohen në ndërtimin e ambienteve akomoduese, rinovimin e banesave të vjetra tradicionale, shndërrimin e tyre në bujtina dhe restorantet që shërbejnë gatime tradicionale dhe produkte tipike autentike. Gjithashtu, investimet e pritshme kanë të bëjnë me aktivitetet e marketingut dhe ato promovuese, linjat e përpunimit dhe paketimit në fermë, zhvillimin e programeve të garantimit të cilësisë dhe marrjen e certifikimit, si dhe me investimet për zhvillimin e shërbimeve të agroturizmit.

Shumica e nismave publike dhe private në sektor janë të përqendruara në nxitjen e ofertës, ndërsa pak është bërë për të krijuar kërkesë. Koordinimi midis nismave të promovimit të kërkesës dhe ofertës në agroturizëm është i rëndësishëm për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit. Në tabelën 1 më poshtë jepet një profil i përgjithshëm i sektorit të agroturizmit në Shqipëri.

²

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: Sektori i turizmit në shifra për vitin 2018

Tabela 1: Profili i zakonshëm i sektorit të agroturizmit në Shqipëri

Modeli	Shumica e tyre janë sipërmarrje të vogla familjare të izoluar. Shumë prej tyre kanë restorante që shesin produkte të prodhuara dhe të përpunuara në fermë.
Pronari	Biznesmenë dhe kuzhinierë me përvojë në menaxhimin e hoteleve. Sidoqoftë, numri i sipërmarrjeve të agroturizmit të administruara nga fermerët po rritet.
Veprimtaria kryesore	Restorant i tipit "nga ferma në tryezë". Përpunimi i prodhimeve të fermës.
Vendndodhja	Vendndodhje me pamje piktoreske pa atraksione turistike pranë. Bujqësi gjithëvjete.
Shumat mesatare të investimit	Investime të vogla 5,000 – 25,000 euro Investime mesatare 100,000-300,000 euro Investime të mëdha 300,000 euro +
Të ardhurat	Shumica kanë mundësi akomodimi/ qëndrimi në fermë, por pjesa më e madhe e të ardhurave nuk rrjedhin nga ky shërbim.
Të ardhurat mesatare	Njësi e vogël agroturizmi 20,000 – 50,000 euro Njësi e mesme agroturizmi 50 000 – 150,000 euro Njësi e madhe agroturizmi 150,000 euro +
Prodhimi i fermës	Kryesisht në shkallë të vogël dhe konsumohet në restorante. Shumica e produkteve nuk janë markë dhe nuk shiten, përveç verës.
Klientët	Kryesisht entuziastë të ushqimit vendas. Pak turistë të huaj nëpërmjet rrjeteve personale të agjencive të udhëtimit.
Sezoni	Kryesisht periudha mars-shtator; megjithatë nuk është mirëpërcaktuar
Marketingu	Me anë të përhapjes së fjalës. Përdorim i mirë i mediave sociale dhe mediave të lajmeve. Mungon ende një markë "agroturizmi"
Marka	Agroturizmit i mungon një temë dhe marketing i përbashkët në të gjitha vendet që mund të shërbejnë si tregje.
Vizibiliteti në internet	Mungesë vizibiliteti në mediat sociale; mungesë e faqeve të internetit; mungesë e vizibilitetit në faqet e prenotimit dhe udhëtimeve
Burimet njerëzore	Mungesë kuzhinierësh të trajnuar ose të certifikuar në disa bujtina në ferma. Mungesë udhërrëfyesish të specializuar vendas për të bashkëpunuar me fermerët, mungesë në kapacitetet menaxheriale. Bazuar në intervistat me një kampion klientësh të agroturizmit, vetëm një pjesë e vogël prej 5-10% kanë bërë trajnim zyrtar.

Burimi: Shtjellim i autorit bazuar në punën fillestare të Besrës, 20183

1.2. KUPTIMI I AGROTURIZMIT PËRKUNDREJT TURIZMIT RURAL

Konceptet e turizmit rural dhe agroturizmit shpeshherë ngatërrohen nga fermat dhe agrobizneset, madje ndonjëherë edhe në nivel institucional, veçanërisht tani që agroturizmi po trajtohet si sektor i vecante dhe aktiviteti biznesi fitimprurës.

Agroturizmi është një aktivitet pritës që zhvillohet në fermë ose në njësi të tjera bujqësore me qëllim tërheqjen e vizitorëve, shpesh duke u mundësuar që të marrin pjesë në aktivitete bujqësore ose aktivitete të tjera ndihmëse që zhvillohen në mjedisin bujqësor. (VKM Nr. 22, datë 12.1.2018).

Çdo formë e turizmit që tregon jetën rurale, artin, kulturën dhe trashëgiminë në vendet rurale, që i sjell komunitetit vendas përfitime ekonomike dhe sociale, si dhe që mundëson ndërveprimin midis turistëve dhe banorëve vendas për një përvojë më të pasur turistike, mund të përkufizohet si turizëm rural (OECD).

Për ta përmbledhur, agroturizmi është një nëndegë e turizmit rural, me një koncept më të gjerë që mund të përfshijë pothuajse çdo veprimtari turistike që zhvillohet në vendet rurale.

VKM nr. 22 përcakton kriteret minimale që duhen përmbushur në mënyrë që një njësi të klasifikohet si njësi agroturizmi. Kriteret lidhen me sipërfaqen minimale të tokës bujqësore, kapacitetet akomoduese dhe shërbyese të ushqimit, burimet e produkteve etj. Më konkretisht, kriteret janë:

- Toka - 1 ha në terren të hapur ose 0,5 ha në zona të mbrojtura;
- Shërbimet - Njësitë e agroturizmit duhet të ofrojnë një nga shërbimet e mëposhtme: ushqim, akomodim, shërbime rekreative;
- Kapacitetet e akomodimit: - 6 deri 30 dhoma akomodimi.
- Arkitektura e ndërtesave: Në përputhje me VKM-të nr. 711 dhe 730 për "Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese".
- Restorantet - nga 6 deri në 60 tavolina për shërbimin e ushqimit;
- Origjina e produkteve - të paktën 30% e ushqimeve dhe pijeve që ofrohen në njësitë e agroturizmit duhet të jenë prodhime të fermës, pjesa tjetër prej 70% mund të blihet nga fermat e tjera përreth. Pra, agroturizmi nuk mund të shihet si i ndarë nga veprimtaritë bujqësore.

Kuptimi i konceptit të agroturizmit është i rëndësishëm për fermerët dhe pronarët e bizneseve për dy arsye të rëndësishme: (1) për t'u kualifikuar për grante; (2) për të përfituar stimuj fiskalë të ofruar nga QSH. Kuptimi i qartë i agroturizmit është gjithashtu i rëndësishëm për institucionet e hartimit të politikave, në mënyrë që të mund të hartojnë politika më të mira për zhvillimin e sektorit.

2. NISMAT E QEVERISË PËR TË MBËSHTETUR ZHVILLIMIN E SEKTORIT

2.1. STRATEGJITË

Sektori në zhvillim i agroturizmit në Shqipëri po tërheq vëmendjen si të nivelit qendror, edhe të atij vendor.

Nisma më e rëndësishme publike e ndërmarrë nga qeveria shqiptare në drejtim të zhvillimit të agroturizmit është programi "100 Fshatrat", një nismë që synon të krijojë modelin e parë të suksesshëm të zhvillimit të integruar rural në Shqipëri. Qëllimi i këtij programi është që në çdo bashki të ketë të paktën dy fshatra të cilat plotësojnë të gjitha standardet infrastrukturore dhe sigurojnë një nivel të kënaqshëm mirëqenieje për fermerët vendas, të cilat do të përfitojnë nga potencialet e pashfrytëzuara të agroturizmit.

Shumica e njësisë të qeverisjes vendore (NjQV-të) në Shqipëri i kanë kushtuar vëmendje agroturizmit gjatë zhvillimit të strategjive të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Procesi i mekanizimit në bujqësi së shpejti do të rezultojë në uljen e nevojës për fuqi punëtore dhe NjQV-të besojnë fuqimisht te agroturizmi si një mundësi për diversifikimin rural, i cili mund të sigurojë të ardhura të qëndrueshme dhe të krijojë punësim duke e kompensuar efektin e mekanizimit të bujqësisë.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (SNZHRB) 2014-2020 e konsideron agroturizmin si një sektor potencial për diversifikimin e të ardhurave dhe krijimin e mundësive të punësimit në zonat rurale.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 përqendrohet në rëndësinë e diversifikimit të ofertës aktuale të turizmit, në mënyrë që të sigurohet zhvillim i integruar i turizmit. Turizmi rural dhe agroturizmi konsiderohen sektorë potencialë që sigurojnë diversifikimin e turizmit dhe zgjerojnë sezonin turistik.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (SKZHQT) 2018-2022, agroturizmi konsiderohet jo vetëm një sektor që mund të ndihmojë promovimin turistik dhe zhvillimin ekonomik, por edhe si një sektor që do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor dhe lokal. SKZHQT thekson rëndësinë e ndërthurjes së turizmit kulturor me agroturizmin, në përpjekje për të rivendosur dhe promovuar qendrat historike të fshatrave.

Qasja e qeverisë përqendrohet në rritjen e ofertës së agroturizmit. Aktualisht nuk ka ndonjë përqendrim të politikave në gjenerimin e kërkesës për agroturizmin. Është e nevojshme që qeveria të mbështesë ofertën, pasi duhen me patjetër mundësitë turistike për të ruajtur kërkesën. Veprimi i qeverisë për koordinimin e klasterave dhe promovimin e tyre për turistët e mundshëm është gjithashtu i domosdoshëm për zhvillimin e industrisë.

Me gjithë rëndësinë që i dedikohet sektorit të agroturizmit në strategji të ndryshme të qeverisë qendrore dhe NjQV-ve, Shqipërisë i mungon një strategji kombëtare për zhvillimin e agroturizmit dhe deri më sot nuk është kryer asnjë studim i zinxhirit të vlerave në agroturizëm.

2.2. STIMUJT FISKALË DHE LIGJORË

2.2.1. Stimujt fiskalë

Në misionin e saj për të promovuar zhvillimin e agroturizmit, qeveria shqiptare miratoi vitin e kaluar një paketë të re fiskale për sektorin e agroturizmit. Në paketën fiskale që miratoi qeveria shqiptare, sektori i agroturizmit do të përfitojë nga disa stimuj tatimorë, përfshirë një normë prej 5 për qind të tatimit mbi fitimin, TVSH të reduktuar në 6 për qind dhe përjashtim nga taksa e infrastrukturës për investimet.

Standardi për certifikimin e bizneseve të agroturizmit gjithashtu është përcaktuar dhe miratuar me VKM-në nr 22, datë 12.1.2018. Standardi përcakton kushtet që duhet të plotësojë një subjekt që operon në sektorin e agroturizmit në mënyrë që të certifikohet. Përbushja e këtyre kushteve paraprahe i bën agrobizneset që synojnë të kthehen në biznese agroturizmi të kualifikueshëm për të përfituar stimuj fiskalë.

Kjo paketë fiskale pritet të tërheqë investime të brendshme dhe të huaja në sektorin e agroturizmit dhe të nxisë zhvillimin e industrisë së turizmit në tërësi. Kohët e fundit, ka një interes në rritje nga sektorët e tjerë për të investuar në agroturizëm dhe investitorët e huaj janë duke eksploruar mundësitë për të investuar në sektorin shqiptar të agroturizmit me disa ide mjaft inovative.

Në nivel vendor, këta stimuj fiskalë pritet t'i motivojnë fermat dhe agrobizneset që të shndërrohen në njësi agroturizmi, duke përfituar kështu nga taksat e ulura dhe duke diversifikuar të ardhurat e tyre. Përjashtimi nga taksa e infrastrukturës për investimet pritet të ketë ndikim të madh në zgjerimin e kapaciteteve akomoduese të sektorit të agroturizmit në Shqipëri. Sikurse është vërejtur kohët e fundit, shumë biznese të përqendruara në bujqësi në të gjithë Shqipërinë kanë investuar në shtimin e ambienteve akomoduese (bujtina) në ofertën e tyre.

2.2.2. Programet kombëtare dhe ndërkombëtare të granteve

Bujqësia është një nga sektorët që është rritur nga mbështetja kombëtare dhe e donatorëve nëpërmjet programeve të granteve. Sidoqoftë, vitet e fundit, agroturizmi ka tërhequr vëmendjen e donatorëve dhe të qeverisë shqiptare si një sektor potencial për krijimin e punësimit dhe diversifikimin e zonave rurale.

Aktualisht, sektori i agroturizmit është duke u mbështetur me grante nga fondet IPARD të BE-së dhe Programi Kombëtar i Granteve i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR). Të dyja programet menaxhohen nga AZHBR, duke ofruar mbështetje me grante për projektet e investimeve në agroturizëm dhe turizmin rural.

Këto programe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e investimeve të reja. Disponueshmëria e shtuar e fondeve për grante pritet të tërheqë më shumë investime dhe kërkesa për kapital investimesh nga sektori i agroturizmit pritet të shtohet.

AZHBR u akreditua si Agjencia e IPARD-it dhe është përgjegjëse për zbatimin e programit. Programi i granteve IPARD II siguron mbështetjen më të madhe që i është dhënë ndonjëherë sektorit të agroturizmit në Shqipëri. Programi rimbursion 65% të investimeve në sektorin e agroturizmit sipas masës nr. 7: Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit, dhe ka një interes në rritje nga investitorët e mundshëm për të aplikuar për këto thirrje për grante. Në tabelën 2 më poshtë paraqiten investimet e pranueshme për sektorin e agroturizmit që mbështet programi IPARD.

Tabela 2: Mbështetja e IPARD II për sektorin e agroturizmit

Programi	IPARD II
Donatorët	BE (75%); Qeveria shqiptare (25%)
Masa 7:	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit
Gama e investimeve	Nënmasa: Agroturizmi dhe turizmi rural (Turizmi natyror)
Intensiteti i mbështetjes	€ 10 000 - € 400 000
Kush mund të aplikojë	65% e totalit të kostove të pranueshme
	Fermerët si persona fizikë ose juridikë, kooperativat bujqësore (SHBB); bizneset mikro dhe të vogla jobujqësore;
	Ndërtimi ose rindërtimi i shtëpive ose ndërtesave sipas stilit tradicional për qëllime turizmi
	<ul style="list-style-type: none"> Objektet dhe ambientet për ofrimin e shërbimeve (informacione dhe ndihmë për të vizituar zonat natyrore; aktivitete rekreative në natyrë); Dhoma akomoduese në fermë, përfshirë të gjitha lehtësitat dhe pajisjet përkatëse për ofrimin e shërbimeve B&B (fjetje dhe mëngjes); Infrastruktura dhe pajisjet për ofrimin e shërbimeve të turizmit në fermë, përfshirë rrugët e brendshme për të hyrë në objektet akomoduese, parqe lojërash për fëmijë, pishina, kënde sportive; parkingje; Mobilie, televizor, marrës satelitor, pajisje për lidhje në internet, pajisje komunikimi radio dhe audio, pajisje për larje dhe hekurosje, pajisje teknologjie informacioni, përfshirë softuerin për administrimin e fermave bujqësore për nevojat e turizmit rural; Rinovimi dhe përshtatja për përdorim e banesave të vjetra/ekzistuese tradicionale në fermën bujqësore, përfshirë bodrumet dhe mullinjët, sipas stilit arkitekturor tradicional/rural të zonës. Pajisje për mirëmbajtjen e vendit turistik dhe peizazhit, përfshirë riciklimin dhe eficientë e energjisë; Ambiente shitjeje në kantinat e verës, dhoma të degustimit të verës, qilarë vere; Ambjente magazinimi, përfshirë ruajtjen e pajisjeve për aktivitete argëtuese; Ndërtimi i stallave për kuajt; Kopshte për qëllime argëtimi dhe lehtësira të tjera në fermë; Ndërtimi i ambienteve të shërbimit të ushqimit (restorante, furra buke, mëngjesore, çadra për të konsumuar vaktet), përfshirë pajisjet e nevojshme);
Investime të pranueshme	

Burimi: Udhëzuesi për aplikantët IPARD II, thirrja e parë

Programi IPARD II ofron grante për makineritë e përpunimit në fermë, për të nxitur prodhimin e produkteve tradicionale si gliko, reçel, turshi etj. Gjithashtu, mbështetje i është dhënë industrisë së artizanatit në zonat rurale. Të gjitha këto aktivitete të kombinuara fuqizojnë zhvillimin e një oferte unike agroturistike për turistët vendas dhe të huaj. Aktualisht, AZHBR është duke vlerësuar aplikimet e thirrjes së parë, ku pritet të zbatohen shumë investime në agroturizëm.

Gjatë 2-3 viteve të fundit, skemat kombëtare të granteve e kanë konsideruar sektorin e agroturizmit si prioritar. Çdo vit, AZHBR organizon disa fushata ndërgjegjësimi për të inkurajuar aplikimet për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të agroturizmit.

Për turizmin rural, programi mbështet investime për ri/ndërtimin e banesave të vjetra, duke i shndërruar ato në bujtina që përfshijnë të gjitha mobilet e nevojshme deri në 5 milion lekë për investim. Për sa i përket agroturizmit, programi siguron 50% të totalit të investimeve në formën e një granti, por jo më shumë se 20 milionë lekë.

Në dy vitet e fundit, skemat e AZHBR-së për agroturizmin kanë mbështetur rreth 40 investime të reja agroturizmi me një vlerë të përafërt totale të grantit prej 4 milionë eurosh. Nga këto skema, rreth 4-6 milionë euro kanë qenë investime private nga vetë aplikantët, duke arritur në një vlerë totale prej rreth 8-10 milionë eurosh.

Investimet e pranueshme të mbështetura nga skema e granteve të AZHBR-së janë të ngjashme me ato të mbështetura nga IPARD. Megjithatë, për të shmangur mbivendosjen, këto fonde ofrohen vetëm për aplikantët që nuk kualifikohen për të përfituar fonde nga IPARD.

Që prej prezantimit të kësaj skeme grantesh, janë krijuar një numër i konsiderueshëm biznesesh të reja agroturizmi. Shumë ferma janë shndërruar në njësi agroturizmi duke kombinuar aktivitetin e tyre bujqësor me ushqimin dhe akomodimin për turistët. Një studim i kryer nga Demirović et al në vitin 2014, konstatoi se mbështetja me fonde publike është një nga faktorët kryesorë për gjallërinë e bizneseve të vogla të turizmit dhe agroturizmit në zonat rurale. Prandaj, është thelbësore të sigurohet qëndrueshmëri në të ardhmen.

Megjithatë, institucionet financiare janë aktorë të rëndësishëm sa i përket shkallës së përthithjes së këtyre fondeve. Në skemat e granteve të IPARD II dhe AZHBR-së, aplikantët duhet të implementojnë investimet me fonde private, duke u rimbursuar pas përfundimit të ciklit të investimeve. Në shumicën e rasteve, aplikantët kërkojnë kredi nga sistemi bankar për të implementuar investimet.

Mbështetja financiare për sektorin e agroturizmit pritet të intensifikohet në vitet e ardhshme dhe kjo ofron një mundësi të shkëlqyer në treg për bankat dhe institucionet financiare, duke qenë se kërkesa për kapital do të rritet në mënyrë të qëndrueshme. Për të qenë të përgatitura për kërkesën në rritje për kapital, bankat dhe institucionet financiare duhet të hartojnë strategji për sektorin e agroturizmit dhe të përgatisin produkte të dedikuara kredie për të përmbushur nevojat financiare të sektorit.

2.2.3. Programi "100 fshatrat"

Programi "100 Fshatrat" është një iniciativë e ndërmarrë nga qeveria shqiptare që synon të krijojë modelin e parë të suksesshëm të zhvillimit të integruar rural në Shqipëri. Ministrinë e Bujqësisë, Infrastrukturës dhe Energjisë, Kulturës, Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me autoritetet bashkiake dhe agjencitë për zhvillimin rajonal kanë krijuar një hartë të 100 fshatrave në të gjithë

Shqipërinë që do të jenë 100 modelet e para të zhvillimit rural. Ato do të sigurojnë një bazë si për shërbimet publike të përmirësuara, ashtu edhe për mirëqenien ekonomike.

Qëllimi i këtij programi ambicioz është të mbështesë komunitetet lokale në ndërtimin e ekonomive të reja. Kultura dhe trashëgimia natyrore do të restaurohen dhe integrohen me elemente të tjera, me qëllim shndërrimin e tyre në vlera ekonomike, duke rritur potencialin turistik për zonat e caktuara.

Për më tepër, Ministria e Infrastrukturës do të sigurojë investime në infrastrukturë në shërbimet publike, siç janë rrugët, ujësjellësi dhe furnizimi me energji elektrike. Ndërkohë, MTM do të jetë përgjegjëse për çështjet mjedisore dhe do të sigurojë mbështetje për strukturat akomoduese.

Qëllimi i programit është të identifikojë të paktën dy fshatra në çdo bashki që përmbushin të gjitha standardet e infrastrukturës dhe që sigurojnë një nivel të kënaqshëm mirëqenieje për fermerët vendas.

Përzgjedhja e fshatit bëhet duke u bazuar në potencialin dhe përvojën e tij në tërheqjen e turistëve, si dhe në prodhimin e produkteve vendase me kërkesë të lartë në tregun ndërkombëtar.

Objektivat e programit janë:

1. Përmirësimi i infrastrukturës publike (Mbështetja për infrastrukturën rrugore, infrastrukturën komunitare, shërbimet publike, infrastrukturën mjedisore dhe turistike, monumentet e trashëgimisë kulturore, peizazhin, qendra multifunkionale komunitare);
2. Zhvillimi ekonomik përmes diversifikimit të veprimtarive ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në zonat rurale, agroturizmi, turizmi rural, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investimet në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbimet e tjera ekonomike). Mbështetje për inkubatorë të produkteve tradicionale vendase, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transport, panairë);
3. Zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit, si dhe shoqërisë civile në zonat rurale, trajnim profesional për gratë dhe të rinjtë, mbështetje për trashëgiminë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe të stilit të jetesës në fshat).

Tri projekte strategjike janë pjesë e programit "100 fshatrat"

I) Krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar

Programi do të ofrojë mbështetje të posaçme për rreth 27 sipërmarrje të reja agroturizmi dhe 150 bujtina. Mbështetje do t'u jepet edhe fermave dhe staneve blegtorale për qëllime të agroturizmit dhe turizmit rural.

II) Rrjeti i inkubatorëve të produkteve tradicionale

Programi do të synojë të krijojë një rrjet "inkubatorësh të produkteve tradicionale", i cili do të sigurojë ambiente në formën e infrastrukturës së gatshme për të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit, duke filluar nga pajisjet e prodhimit/magazinit, linjat e paketimit dhe marketimit, mbështetja për standardizimin dhe certifikimin, si dhe ambientet për shitjen e produkteve.

III) Rrjeti i markave/dyqaneve që shesin produkte tradicionale shqiptare

Është e vështirë që produktet tradicionale shqiptare të depërtojnë në tregjet dhe dyqanet e shitjes me pakicë. Programi do të synojë krijimin e një rrjeti të markave/dyqaneve që do të specializohen në shitjen e produkteve autentike shqiptare, në veçanti të produkteve tradicionale. Ndihma financiare për krijimin e këtij rrjeti do të sigurohet në kuadër të programit "100 fshatrat".

Në kuadër të këtij programi, parashikohet që në vitet në vijim të bëhen shumë investime në agroturizëm për 100 fshatrat e zgjedhura. Ky program përfaqëson një dritare në treg për bankat dhe institucionet financiare që duhet të përgatitin produkte të përshtatura kredie. QSH u ka bërë vazhdimisht thirrje institucioneve financiare për të mbështetur me kredi nismat në agroturizëm në 100 fshatrat, në mënyrë që të kontribuojnë në zbatimin me sukses të programit.

3. ZONAT ME MUNDËSI TË LARTA PËR ZHVILLIMIN E AGROTURIZMIT

3.1. ZONAT ME MUNDËSI TË LARTA ZHVILLIMI

Bujqësia dhe turizmi janë ndër sektorët më të rëndësishëm ekonomikë në Shqipëri sa i përket gjenerimit të të ardhurave dhe punësimit. Ndërthurja e këtyre dy sektorëve ofron një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e agroturizmit në Shqipëri.

Bujqësia përbën 19% të PBB-së dhe rreth 40% të punësimit të përgjithshëm në Shqipëri, duke siguruar bazën për zhvillimin e agroturizmit. Për më tepër, turizmi është një nga sektorët me rritjen më të shpejtë. Bujqësia ka një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë në Shqipëri dhe nga ky këndvështrim ka një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit në të gjithë vendin.

Meqenëse agroturizmi kombinon aktivitetet e bujqësisë dhe turizmit, kur bëhet fjalë për një përvojë gjithëpërfshirëse agroturizmi që përfshin qëndrimet në fermë, angazhimin në aktivitete bujqësore dhe mundësinë për të eksploruar atraksionet natyrore dhe kulturore, si dhe vendet arkeologjike në zonat afër fermës, ia vlen të eksplorohehen zonat me më shumë potencial. Gjithashtu, MTM është duke i dhënë përparësi ndërthurjes së turizmit kulturor me agroturizmin.

Duke pasur parasysh ndërthurjen e bujqësisë dhe turizmit, **qarku i Korçës** ka një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it për bujqësinë, ka më shumë se 30,000 ferma dhe agrobiznese që operojnë në qarkun e Korçës. Shumica e këtyre fermave kanë pranë atraksione natyrore dhe kulturore. Për më tepër, sipas MTM, në qarkun e Korçës janë regjistruar dhe funksionojnë 121 struktura akomodimi të përbëra nga njësi agroturizmi dhe bujtina rurale. Në bazë të të dhënave të MBZHR-së, në qarkun e Korçës ka rreth 25 njësi agroturizmi funksionale. Qarku është i njohur për kuzhinën e pasur me shumë gatime tradicionale dhe produkte bujqësore tradicionale.

Qarku i Korçës është i pasur me atraksione kulturore, natyrore dhe arkeologjike. Shumica e tyre janë të përhapura në zonat rurale. Korça ka pasuri të jashtëzakonshme natyrore, duke përfshirë liqene dhe male. Në vitin 2018, bazuar në të dhënat e MTM-së, rreth 530,000 turistë vizituan muzetë, vendet arkeologjike dhe parqet kombëtare në qarkun e Korçës. Disa nga fshatrat më të spikatur për agroturizmin dhe turizmin rural janë: Voskopoja, Boboshtica, Dardha dhe Vithkuqi. Lini, Tushemishti, Pusteci, Gorica e Vogël dhe Zaroshka. Mijëra turistë vizitojnë këto fshatra çdo vit, por nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e përafërt të turistëve. Të gjitha këto fshatra janë pjesë e programit të "100 fshatrave".

Berati është një tjetër qark me potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit. Në qarkun e Beratit ka rreth 26,000 ferma dhe agrobiznese, shumica prej të cilave ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e agroturizmit. Në qarkun e Beratit ka rreth 60 njësi akomodimi të regjistruara dhe funksionale, të përbëra prej njësisive të agroturizmit dhe bujtinave në zonat rurale. Bazuar në të dhënat e siguruar nga MBZHR, ekzistojnë 12 njësi agroturizmi në Berat. **Qarku i Beratit** është i njohur për vlerat e pasura të trashëgimisë historike, kulturore, etnografike, arkitekturore dhe natyrore. Qarku i Beratit është gjithashtu i pasur me burime natyrore dhe përfshin dy burime unike dhe të mirënjohura në mbarë vendin - malin e Tomorrit dhe Kanionet e Osumit. Në vitin 2018, rreth 380,000 turistë

vizituan muzetë, kështjellat dhe zonat e mbrojtura në qarkun e Beratit. Kalaja e Beratit dhe Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri" janë ndër atraksionet më të vizituara. Për të kombinuar më mirë përvojën turistike (qëndrimin në fermë + vizitat në atraksionet natyrore/kulturore), njësitë e reja të agroturizmit duhet të bashkëpunojnë me operatorët turistikë. Ka potencial të mirë për zhvillimin e agroturizmit në fshatrat Bogovë, Roshnik dhe Vertop. Fshatrat e tjerë me mundësi të mira për zhvillimin e agroturizmit janë: Qafë-Dardhë, Malas-Breg, Kozarë, Blezenckë dhe Kapinovë. Këto fshatra janë përfshirë gjithashtu në programin e "100 fshatrave" dhe do të përfitojnë nga investimet në infrastrukturë dhe asistencë teknike në zhvillimin e bizneseve të agroturizmit. Sidoqoftë, pavarësisht potencialit të tyre të shkëlqyer, turizmi rural dhe agroturizmi duket se janë më pak të zhvilluar në këto zona.

Vlora dhe Saranda janë zonat më të njohura për turizmin në Shqipëri. Në vitin 2018, rreth 950,000 turistë vizituan muzetë, parqet kombëtare, kështjellat dhe atraksionet e tjera. Në qarkun e Vlorës ka 698 njësi akomoduese të regjistruara dhe funksionale. Turizmi rural dhe agroturizmi duket se janë më pak të zhvilluar, pavarësisht potencialit të madh që disponohet. Fshatrat përgjatë rivierës shqiptare, si Palasë, Dhërmi, Vuno, Himarë, Qeparo, Borsh dhe Lukovë, përfaqësojnë mundësi premtuese për zhvillimin e agroturizmit. Sidoqoftë, meqë shumica e vizitorëve vijnë për të shijuar diellin dhe detin, njësitë akomoduese janë zakonisht hotele që janë aktive vetëm gjatë sezonit veror. Krijimi i njësive të agroturizmit që ndërthurin qëndrimin në fermë me shijimin e plazheve të bukura dhe që ofrojnë një përvojë unike për turistët që vizitojnë rajonin, do të bënin të mundur që turizmi në këto zona të zhvillohet gjatë gjithë vitit.

Lugina e Shushicës ofron gjithashtu një mundësi të mirë për zhvillimin e agroturizmit. Pozicioni gjeografik, peizazhi i bukur dhe cilësia e produkteve cilësore vendase përbëjnë një fillim të mirë për këtë lloj turizmi. Dymbëdhjetë fshatra në qarkun e Vlorës janë përfshirë në programin "100 fshatrat", të identifikuar si fshatra me potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit.

Gjirokastra u përfshi në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2005 dhe është një nga qarqet më të vizituara në Shqipëri për qëllime turizmi. Gjirokastra ka shumë shtëpi dykatëshe të veçanta të ndërtuara në shekullin e 17-të. Qyteti ka gjithashtu një pazar, një xhami të shekullit të 18-të dhe dy kisha të së njëjtës periudhe. Gjatë vitit 2018, vizituan muzetë, parqet kombëtare, kështjellat dhe atraksionet e tjera në qarkun e Gjirokastrës rreth 150,000 turistë. Qarku është i mirëzhvilluar në bujqësi dhe blegtori, me më shumë se 10,000 ferma të përziera të përfshira në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Gjirokastra ka një traditë të lashtë të kuzhinës, me shumë gatime tradicionale. Qarku i Gjirokastrës regjistron 62 njësi akomoduese funksionale, një pjesë e të cilave janë bujtina dhe njësi agroturizmi.

Gjirokastra është gjithashtu e njohur për shumëllojshmërinë e produkteve tradicionale që ofron (gliko dhe reçel, prevede, mish i bagëtive të imëta etj.). Inkubatori i parë i produkteve tradicionale i mbështetur nga skemat e granteve të AZHBR-së gjendet në Gjirokastrë. Ky qark është identifikuar si qarku me numrin më të madh të fshatrave të përfshirë në programin "100 fshatrat". Ndërthurja e bujqësisë dhe turizmit në këtë qark do të gjeneronte të ardhura shtesë për fermat dhe vende të reja pune, duke i bërë zonat rurale më tërheqëse për të rinjtë.

Në **rajonin verior të Shqipërisë**, ekzistojnë disa modele për zhvillimin rural dhe të agroturizmit, që mund të ndiqen edhe në krahina të tjera të Shqipërisë. Fshatrat e Thethit në qarkun e Shkodrës, Valbonës në qarkun e Kukësit dhe Lurës në qarkun e Dibërës janë ndër atraksionet më të njohura rurale dhe agroturistike në Shqipëri. Fermat në këto fshatra ndodhen në peizazhe

të jashtëzakonshme afër vendeve të trashëgimisë natyrore (Parku Kombëtar i Thethit, Lumi i Shalës, Lugina e Valbonës, Parku Kombëtar i Lurës dhe shtatë liqenet etj.). Ekzistojnë 690 njësi akomodimi (hotele, bujtina, ambiente qëndrimi në fermë etj.), shumica e të cilave ndodhen në qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Bazuar në të dhënat e MBZHR-së, në rajonin verior ekzistojnë më shumë se 40 njësi agroturizmi. Në 10 vitet e fundit, këto atraksione turistike patën rritje të numrit të bujtinave. Zona ka përfituar nga projektet e financuara nga donatorët për të zhvilluar ofertën e saj rurale dhe agroturistike. Rreth 1,2 milionë turistë vizituan muzetë, kështjellat dhe parqet kombëtare në zonat e mbrojtura të veriut të Shqipërisë në vitin 2018, ku destinacioni kryesor ishte Shkodra, me 70 përqind të totalit të vizitave.

Sipas një studimi të GIZ për turizmin rural, në Theth ka më shumë se 35 familje që kanë shndërruar banesat e tyre të vjetra në bujtina me një kapacitet total akomodimi prej rreth 400 shtretërisht. Valbona ka ndjekur të njëjtën rrugë zhvillimi, ndërsa Lura ofron një kapacitet akomodimi shumë më të ulët. Në këto zona (si dhe në fshatrat e tjera të përfshirë në programin "100 fshatrat"), ekziston një potencial i madh për të kombinuar agroturizmin me qëndrimet në fermë që do të pasurojnë më tej përvojën turistike. Potenciali më i madh për këto fshatra është fluksi i lartë i turistëve të huaj (rreth 16,000 në 2015) dhe rritja e shpejtë e kërkesës për shërbime agroturizmi.


Shqipëria e Mesme ofron mundësi të mira për zhvillimin e agroturizmit. Njëzet e pesë fshatra nga kjo krahinë janë përfshirë në programin "100 fshatrat", duke arritur në 25% të mbulimit të përgjithshëm të programit. Disa nga sipërmarrjet më të mëdha dhe më të njohura të agroturizmit në Shqipërinë e Mesme janë Agroturizmi "Huqi", UKA Farm, Nano Resort, Agroturizmi "Gjepalaj" etj.

Ka një interes në rritje të investitorëve vendas dhe të huaj për investime në agroturizëm në këtë rajon. Kohët e fundit, ka pasur një tendencë të dukshme në rritje të restoranteve të tipit "nga ferma në tryezë", çka është aktualisht modeli më i zakonshëm i agroturizmit në këtë zonë. Ky rajon kontribuon në rreth 50% të PBB-së së vendit dhe përqendrimi i lartë i kapitalit rrit mundësinë e investimeve të reja në agroturizëm.

Gjatë vitit 2018, atraksionet turistike, si muzetë, kështjellat, sitet arkeologjike dhe zonat e mbrojtura në Shqipërinë e Mesme u vizituan nga rreth 660,000 turistë. Ekzistojnë më shumë se 700 struktura akomodimi, duke përfshirë bujtinat në zonat rurale dhe bizneset e agroturizmit (15-20 sipas të dhënave nga MBZHR).

Në figurën 2 më poshtë janë paraqitur vizualisht zonat me mundësitë më të larta për zhvillimin e agroturizmit. Kategorizimi sipas numrit të njësive funksionale të agroturizmit bazohet në të dhënat e vitit 2018 nga Ministria e Bujqësisë dhe mund të gjendet në shtojcën 1 në fund të dokumentit. Është e rëndësishme të ritheksohet se potenciale të pashfrytëzuara për zhvillimin e agroturizmit ekzistojnë në të gjithë Shqipërinë dhe zonat me ngjyrë të theksuar në hartë paraqesin ato zona ku ekziston një potencial i madh për të kombinuar bujqësinë dhe turizmin. Bazuar në të dhënat për vitin 2018, Korça është qarku me numrin më të madh të njësive funksionale të agroturizmit, e ndjekur nga Shkodra, Kukësi dhe Lezha.

Figura 2: Harta e potencialeve të agroturizmit dhe shpërndarja e njësive agroturistike në vitin 2018



3.2. MODELE SUKSESI

Praktikat e ndjekura nga modelet e suksesshme janë të dobishme për përcaktimin e standardeve bazë për aftësitë, kompetencat dhe efikasitetin. Shkëmbimi i praktikave më të mira është i dobishëm për të identifikuar dhe plotësuar mangësitë në njohuri, për të gjeneruar ide krijuese dhe inovative dhe për të përmirësuar procesin e vendimmarrjes. Praktikrat më të mira të ndjekura nga modelet e suksesit shërbejnë për përcaktimin e standardeve dhe hartimin e një udhërrëfyese që duhet të ndiqet për të garantuar suksesin. Më poshtë janë paraqitur dy sipërmarrje agroturizmi të cilat konsiderohen të jenë modele të suksesshme: "Mrizi i Zanave", njësia agroturistike më e madhe në shkallë dhe veprimtari dhe më e njohura në Shqipëri; dhe Agroturizëm Huqi - një biznes agroturizmi inovativ dhe i suksesshëm i themeluar nga familja Huqi.

"Mrizi i Zanave" - Mendoni në nivel global, ushqehuni në nivel lokal

"Mrizi i Zanave" është një qendër agroturizmi në Fishtë, afër Lezhës. Është një vend ku turistët që vijnë nga e gjithë Shqipëria dhe vizitorët e huaj kalojnë kohën ndërsa shpëtojnë për tu larguar nga zhurma dhe kaosi urban. "Mrizi" është veçanërisht i njohur për kuzhinën e tij të pasur që reklamon disa nga gatimet më të mira tradicionale të krahinës. Te "Mrizi i Zanave", i cili mban emrin e veprës poetike të Gjergj Fishtës, shqiptarët dhe turistët e huaj shkojnë për të shijuar kuzhinën tradicionale të përgatitur me produkte autentike vendase. "Mrizi i Zanave" shtrihet në një kodrinë të blertë dhe ka moton "refuzimi i rutinës së përditshme, reflektim, një shteg në natyrë, ku janë skalitur në dru vargjet e poetit Gjergj Fishta".



Bujtina Mrizi i Zanave

Mrizi i Zanave ka zhvilluar një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktiviteteve agroturistike. Turistët mund të shijojnë gatimet tradicionale në restorant, të kalojnë natën në bujtinë, në një ambient arkitekturor unik të ndërtuar në harmoni me natyrën dhe të përfshihen në aktivitete bujqësore, si vjelja, ushqyerja e kafshëve, njohja e proceseve të ndryshme bujqësore etj. Kompania ka investuar në disa njësi të brendshme të përpunimit të verës, djathit, frutave dhe mishit, ku turistët mund të vëzhgojnë aktivitetet e përditshme të përpunimit. Vizitorët mund të hipin në "Autobusin Banane", një varg me fuçi të ngjyrave të ndryshme që tërhiqet nga një traktor i fermës.

Ideja për hapjen e "Mrizi i Zanave" i lindi fillimisht Z. Altin Prenga. Z. Prenga u kthye nga Italia ku jetoi për 11 vjet dhe vendosi të hapte biznesin. Tradita e familjes së një kuzhinieri ishte një nga avantazhet e kësaj iniciative. "Mrizi i Zanave" si njësi agroturizmi mund të shërbejë si një model i agroturizmit standard, i cili mund të përsëritet në krahina të tjera të Shqipërisë.

Sot, "Mrizi i Zanave" është biznesi agroturistik më i madh për nga shkalla dhe funksionimi dhe bashkëpunon me mbi 300 familje rurale, të cilave u blen produkte bujqësore. Roli i tij këshillues për fermerët ka sjellë ndryshime të jashtëzakonshme në sjelljen dhe praktikrat e fermerëve aty pranë.

Pikat e forta

- Njësi e çertifikuar agroturizmi
- Iniciativë "Sloë Food": Konsumoni produkte vendase
- Vizion me pronësi të plotë
- Përvoja: Shije, shërbim, pamje
- Kuzhinë origjinale
- Sipërfaqe të mëdha toke bujqësore, treg i vetë fermës
- Përpunim në fermë (Verë, djathë, fruta, mish).
- Shoqatë me më shumë se 300 fermerë, ofron këshillim falas për fermerët
- Ngritur në Fishtë: Histori dhe natyrë
- Staf i trajnuar

Të dhënat financiare

Investimet	Kompania ka bërë shumë investime ndër vite. Gjatë 2-3 viteve të fundit janë investuar rreth 300,000 euro.
Xhiro	650,000 euro (fiskale)
Marzhi i fitimit	Marzhi aktual i fitimit është rreth 9% (llogaritja është e bazuar në të dhënat e bilancit)
Skemat e granteve	"Mrizi" ka përfituar fonde nga skemat e granteve SARED të financuara nga qeveria daneze dhe GIZ për ngritjen e një fabrike qumështi, ku përfshiheshin ndërtimi dhe pajisjet e nevojshme. Gjithashtu, biznesi përfitoi mbështetje nga grantet e AZHBR-së për të rindërtuar bujtinën (ajo e treguar më lart).
Financime të tjera	"Mrizi" është mbështetur ndër vite nga kreditë e biznesit, në mbështetje të investimeve.

Agroturizëm "Huqi"



Shtëpi druri në "Agroturizëm Huqi"

Agroturizëm Huqi" është një nga bizneset më të njohura dhe inovative të agroturizmit në Shqipëri, me një ofertë gjithëpërfshirëse agroturizmi. Biznesi ndodhet në fshatin Radë, Durrës. Ideja për biznesin daton që nga viti 2008, kur z. Huqi filloi të kultivojë tokën dhe bëri investime në infrastrukturë fizike (rrugë, energji elektrike etj.), ndërsa ngrinte fermën e tij.

Faza e dytë e investimeve përfshiu ndërtimin e një restoranti, ku ofrohen shumë gatime tradicionale dhe produkte organike për turistët e shumtë vendas dhe të huaj; çadra për konsumimin e vakteve afër liqenit, të cilat ofrojnë një përvojë

unike; shtatë shtëpi tradicionale prej druri (shtëpiza verimi) për akomodim me pamje piktoreske të liqenit; zona të ndryshme për të peshkuar e lundruar me varkë në liqen; zona rekreative dhe park lojërash për fëmijë etj.

Agroturizëm "Huqi" shtrihet në një sipërfaqe prej 7 hektarësh, nga të cilat 3,5 hektarë përbëhen nga liqeni, dhe 3,5 hektarë nga toka në një terren kodrinor. Në fermë kultivohen fruta dhe perime të ndryshme dhe z. Huqi po planifikon të investojë në linjat e përpunimit të vajit të ullirit dhe prodhimit të verës.

Turistët që vizitojnë Agroturizëm "Huqi" mund të shijojnë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh:

- Akomodim në shtëpi druri (shtëpiza verimi) me një pamje piktoreske të liqenit.
- Shërbim i ushqimit në restorant me gatime tradicionale. Vizitorëve u ofrohet gjithashtu mundësia e hyrjes në ambientet e barbekusë dhe e përdorimit të pajisjeve të skarës, ku ata janë të lirë të gatujnë vetë dhe të shijojnë pjata të ndryshme.
- Përvojë praktike me aktivitetet në fermë (ushqyerja e kafshëve; soditja dhe ushqyerja e rosave dhe patate në liqen; vjelja e frutave dhe perimeve; marrja pjesë në përpunimin e frutave dhe produkteve të tjera)
- Shitje direkte të produkteve të freskëta dhe të përpunuara. Blerja e produkteve të freskëta nga vetë vizitorët. Një pjesë e produkteve blihen nga fermat përreth.
- Aktivitete argëtuese (peshkim; lundrim me varkë; kalërim; vrapim në natyrë);
- Regjistrim i videove. Peizazhet dhe ambientet e bukura me liqenin dhe kodrën ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për regjistrimin e videove.

Pikat e forta:

- Njësi e çertifikuar agroturizmi
- Vendndodhja: ndërmjet Tiranës dhe Durrësit (zonat më të mëdha urbane në Shqipëri);
- Ambienti: Liqeni, kodrat, fermat, konstruksioni
- Gamë e gjerë shërbimesh
- Ngjarje dhe festa lokale
- Kuzhinë origjinale: Pulë/mish fshati i pjekur në furrë të hapur
- Prani e fuqishme në mediat sociale

Të dhënat financiare

Investimet	Kompania ka investuar qindra e mijëra euro ndër vite dhe ka plane për investime të tjera
Xhiro	Rreth 160.000 euro (të deklaruar)
Marzhi i fitimit	Marzhi i fitimit aktual është rreth 10% (llogaritje bazuar në të dhënat e bilancit)
Skemat e granteve	Ka marrë një grant prej rreth 15.000 eurosh nga AZHBR për disa prej shtëpive prej druri
Financime të tjera	Kredi bankare rreth 350.000 euro (bilanci) Kompania ka plane të tjera investimesh për të pasuruar ofertën e agroturizmit dhe është e hapur për kredi bankare dhe lloje të tjera të financimit

3.3. HARTËZIMI I PROJEKTEVE/INICIATIVAVE NË FUSHËN E AGROTURIZMIT

Ekzistojnë disa projekte të financuara nga donatorët e përfshirë në sektorin e agroturizmit në Shqipëri. Projektet janë përqendruar në promovimin e ofertës dhe kërkesës në sektorin e agroturizmit dhe pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në transformimin e sektorit.

Fondi për Investimet dhe Financimin në Turizëm (FIFT), USAID, Ambasada e Suedisë në Tiranë dhe Qendra për Edukimin Ekonomik dhe Biznesin (CEBE Albania) po zbatojnë një projekt 32-mujor në vlerën e 1.435 milion dollarëve, i cili krijon Fondin për Investimet dhe Financimin në Turizëm në Shqipëri. Fondi do të jetë një shoqatë financiare jofitimprurëse e përbërë prej shumë partnerësh dhe në pronësi të anëtarëve, që do të ofrojë asistencë teknike për MNVM-të që operojnë në sektorin e turizmit në Shqipëri.

FIFT kontribuon në përmirësime në sektorin e turizmit, përfshirë mjedisin e favorshëm të biznesit në Shqipëri dhe kapacitetet e fuqisë punëtore, dhe do të shërbejë si katalizator për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Fondi do t'i përqendrojë përpjekjet në zhvillimin e komuniteteve të agroturizmit dhe ekoturizmit në zonat rurale, zonat natyrore dhe zonat e mbrojtura. FIFT ofron mundësi bashkëinvestimi, të ndjekura nga mbështetje e specializuar këshillimore, për të përforcuar investimet dhe për të rritur mundësinë drejt suksesit. Më shumë se 70 MNVM do të mbështeten nëpërmjet kapitalit dhe shërbimeve këshilluese të biznesit.

Nisma e FAO-s për zhvillimin rural në Shqipëri. Kuadri i ri i Zhvillues i FAO-s dhe Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe FAO-s, do të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet për zhvillimin e Shqipërisë, duke përfshirë periudhën deri në vitin 2021. Një fokus i fortë i kësaj marrëveshjeje të re është mbështetja e rritjes së të ardhurave rurale duke promovuar agroturizmin dhe përmirësimin e mbështetjes së dhënë për fermerët e vegjël, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale. Mbështetja për kuadrin ligjor dhe institucional të Shqipërisë në prodhimin e ushqimeve dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike ka për qëllim rritjen e konkureshmërisë dhe qëndrueshmërisë së vendit.

Projekti D2T. USAID dhe qeveria e Suedisë po financojnë një projekt trevjeçar prej 1 milion USD të D2T - që do të ndihmojë në përparimin e një sektori të qëndrueshëm të turizmit të integruar në Bashkinë e Dibrës duke zhvilluar agroturizmin ekologjik, natyror, kulturor. Projekti inovator D2T është duke u zbatuar nga Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Vendore (ALCDF) në partneritet të ngushtë me Bashkinë e Dibrës, CNVP-në dhe grupin lokal të veprimit, Dibra Turistike.

D2T synon të rrisë numrin e turistëve në Dibër dhe të përmirësojë cilësinë e përvojave të tyre turistike. Nëpërmjet partneriteteve me bizneset dhe qeverisjen vendore, projekti do të zhvillojë dhe marketojë atraksione agroturistike natyrore, kulturore, ekologjike, si shtigje për ngjitjet në mal dhe çiklizmin; do të përmirësojë fshatrat dhe bujtinat dhe tradicionale. Projekti D2T ka investuar mesatarisht 10,000 – 15,000 euro për çdo bujtinë dhe që të gjitha kanë potencialin të shndërrohen në njësi të plota agroturizmi. Projekti pritet të ketë një ndikim të madh në transformimin e sektorit të agroturizmit në qarkun e Dibrës.

IntoAlbania. IntoAlbania (Turizmi Inovativ në Shqipëri) është një projekt për zhvillimin e turizmit i financuar nga USAID (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) dhe Suedia (Ambasada e Suedisë në Shqipëri) dhe i zbatuar nga Creative Business Solutions CBS.

IntoAlbania.com është një platformë e marketingut të destinacioneve për turizmin shqiptar. Misioni i IntoAlbania-s është të promovojë Shqipërinë në botë, të ruajë trashëgiminë e saj, të pasqyrojë identitetin e saj të gjallë dhe të forcojë ekonominë vendase përmes mundësive të shitjeve nepermjet internetit. IntoAlbania është një iniciativë e rëndësishme në drejtim të gjenerimit të kërkesës për pushime agroturistike në Shqipëri.

USAID CEED – Projekti i Agroturizmit në Shqipëri. Projekti i Agroturizmit në Shqipëri i financuar nga USAID dhe qeveria e Suedisë synon të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve në zonat rurale të Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Pukës përmes punësimit në një sektor të qëndrueshëm dhe të gjallë agroturizmi. Projekti mbështet krijimin e modeleve të riprodhueshme të agroturizmit dhe ofron asistencë teknike për gjashtë ferma agroturistike plotësisht funksionale në këtë qark. Projekti ka mbështetur fermat agroturistike me investime për të hapur bujtina plotësisht funksionale. Secila nga gjashtë fermat ka përfituar 25,000-30,000 euro nga projekti për t'i shndërruar shtëpitë e tyre të vjetra në bujtina me fjetje dhe mëngjes. Projekti ka nxitur investime private, të cilat përbënin rreth 20% e totalit të investimeve. Ai zbatohet nga një OJQ shqiptare, CEED Albania, e cila u siguron sipërmarrësve njohuri rreth biznesit nëpërmjet programeve të saj të akselerimit dhe i lidh pjesëmarrësit me mentorët dhe me një komunitet të sipërmarrësve që mund të ndihmojnë për t'i zhvilluar bizneset e tyre të vogla.

Brand Albania. CBS është duke implementuar projektin "Brand Albania", një projekt i financuar nga USAID për të zhvilluar një markë kombëtare për produktet ushqimore autentike shqiptare. Projekti synon të ofrojë asistencë teknike të drejtpërdrejtë për sektorin privat, ndërsa inkurajon mbështetjen, bashkëpunimin dhe një PPP me institucionet e qeverisë shqiptare (QSH) për të krijuar "Brand Albania", një organizatë markë ombrellë që promovon produktet cilësore vendase dhe nismat e lidhura me turizmin.

Projekti "Brand Albania", në bashkëpunim me partnerët e tjerë zbatues në Shqipëri, kanë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese për promovimin e produkteve cilësore vendase dhe të nismave të lidhura me turizmin, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të agroturizmit. Është zhvilluar dhe regjistruar një markë kolektive për "Brand Albania" nën emrin "OriginAL", me qëllim rritjen e cilësisë së produkteve dhe përmirësimin e mundësive për NVM-të lokale.


RISI Albania, binjakëzimi shqiptaro-zviceran në agroturizëm. Risi Albania është duke pilotuar një binjakëzim dhe shkëmbim ekspertize mes bizneseve zvicerane dhe shqiptare në përputhje me strategjinë "100 fshatrat". Qëllimi i kësaj nisme është ofrimi i njohurive për sipërmarrësit shqiptarë të përfshirë në agroturizëm se si t'i bëjnë turistët të qëndrojnë më gjatë në Shqipëri, të udhëtojnë më thellë në zonat rurale dhe të vizitojnë vendin gjatë gjithë vitit, ashtu siç bëjnë kur vizitojnë Zvicrën.

Një numër biznesesh agroturistike nga nisma "100 fshatrat" kanë vizituar bizneset zvicerane për të vëzhguar praktikat më të mira dhe për të krijuar lidhje biznesi. Kjo nismë binjakëzimi filloi me një vizitë shkëmbimi të tetë pronarëve të bizneseve agroturistike zvicerane në Shqipëri, të cilët takuan mbi dyzetë biznese agroturistike me potencial të lartë për shkëmbim me homologët zviceranë.

Fushata ndërgjegjësuese - Zhvillimi rural përmes mbështetjes së agroturizmit. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Firences dhe Bankën Credins, po organizojnë seminare ndërgjegjësuese në të gjithë Shqipërinë. Seminarët kanë për qëllim informimin e fermerëve dhe agrobiznesit mbi potencialet e agroturizmit në zhvillimin rural dhe për diversifikimin e aktiviteteve të tyre aktuale. Fermerët njihen me shembujt më të mirë nga rajoni i Toskanës në Itali, si dhe me mundësitë e financimit të ofruara nga Banka Credins.

3.4. MODELIMI I PËRVOJËS

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të biznesit të agroturizmit është se ai mbështetet në burimet e veta dhe është përgjegjës për të gjitha shërbimet ndaj klientëve. Sektori i agroturizmit ka një mundësi më të madhe suksesi nëse fermerët dhe agrobizneset kuptojnë se "pushimet" po ngjishen brenda fundjavës, për tu përshtatur me jetën impenjuese profesionale dhe shkollore; udhëtarët nisen në udhëtime më të shkurtra me makinë nga shtëpitë e tyre në zonat urbane/ periferike drejt fshatit; njerëzit janë në kërkim të përvojave të reja dhe mundësive për t'i shijuar ato në familje.



Burimi: Lattanzi, 2005

Qëllimi kryesor i udhëtimit në zonat rurale është për të kaluar kohën e lirë⁴. Fermerët do të bënin mirë ta kuptonin këtë tendencë. Krijimi i aktiviteteve të kohës së lirë në ferma ka potencialin për të tërhequr dhe mbajtur vizitorët në zonat rurale. Sipërmarrjet e agroturizmit duhet të ofrojnë më shumë se ato që rriten në fermë. Ushqimet speciale, si reçeli dhe marmelata, punimet artizanale të zonës, ushqyerja e kafshëve, pjesëmarrja në seminare dhe prezantime, që të gjitha bëjnë që shumë ferma agroturizmi të jenë destinacion për aktivitete dhe eksperiencë, aq sa edhe një vend për të blerë ushqime të freskëta të kultivuara në fermë. Është e rëndësishme t'i lejoni vizitorët që të përjetojnë një përvojë të përditshme të jetës tradicionale në një fshat apo fermë. Aktivitetet bujqësore ku turistët mund të përfshihen në përvoja praktike mund të përfshijnë:

- Vjeljen e kërpudhave, erëzave, frutave, ullinjve dhe rrushit, korrja dhe vënien e barit mullar;
- Mbjelljen, plugimin, punët në serrë dhe fidanishte
- Menaxhimin e blegtorisë, mjeljen, kullotjen e kopesë, qethjen, zhytjen në banjat me dezinfektues, bletarinë;
- Përpunimin e ushqimit, shtypjen e rrushit, shtypjen e ullirit, shoshitjen, bluarjen;
- Shëtitje dhe ekskursionë, shëtitjet me udhërrëfyes në fermë dhe nëpër kultura të ndryshme bujqësore, shëtitjet me karrocë me kalë, ngarja e qerreve me sanë, tregu lokal;

4 Lattanzi, 2005

Sezoni i agroturizmit në Shqipëri nuk është i mirëpërcaktuar, megjithatë, periudha mars/prill deri në shtator/tetor është më e zakonshme për aktivitetet e agroturizmit. Mundësitë për agroturizëm ekzistojnë gjatë gjithë vitit, megjithatë kërkohen më shumë përpjekje për të patur sukses në këtë drejtim.


3.5. BURIMET E TË ARDHURAVE NË AGROTURIZËM

Agroturizmi po promovohet si një mënyrë për të gjeneruar të ardhura shtesë për fermat dhe ka shumë mënyra për të gjeneruar shitje. Shtimi i shërbimeve turistike do të shërbente si strategji diversifikuese për fermat, duke kontribuar në prurje më të qëndrueshme të të ardhurave. Ky seksion përshkruan burimet potenciale të të ardhurave për destinacionet e agroturizmit. Informacioni i paraqitur i referohet pjesërisht një studimi të kryer nga Ochterski dhe Roth (2008) dhe është përshtatur me kontekstin shqiptar.

- **Tarifa e akomodimit**

Akomodimi është një shërbim i rëndësishëm për një përvojë gjithëpërfshirëse agroturizmi. Njësitë e reja të agroturizmit kanë ambiente akomodimi dhe shumica e fermave po investojnë në rindërtimin e banesave të tyre të vjetra për qëllime turistike. Tarifat e akomodimit paraqesin një burim të mirë të ardhurash për këto ferma. Çmimi mesatar për një dhomë çift (fjetje dhe mëngjes) në Evropë është rreth 75,0 euro, ndërsa në Shqipëri çmimi mesatar është 40 euro. Çmimet shumë më të ulëta në Shqipëri e bëjnë sektorin e agroturizmit ekonomikisht tërheqës për turistët e huaj. Në të gjithë rajonin çmimet janë pothuajse kudo të barabarta. Për më shumë informacion, shihni figurën 2 më poshtë.

Figura 2: Çmimet mesatare për fjetje e mëngjes në akomodimet në fermë (Euro)



Burimi: Booking.com, TripAdvisor, IntoAlbania etj.

- **Tarifa e ushqimit dhe degustimit**

Tarifat e ushqimit dhe degustimit sigurojnë forma të tjera të gjenerimit të të ardhurave për njësitë e agroturizmit. Shumica e njësive të agroturizmit në Shqipëri kanë investuar në restorante

dhe shërbejnë një gamë të gjerë gatimesh tradicionale, të cilat preferohen shumë nga turistët vendas dhe të huaj. Të ardhurat nga shërbimi i ushqimit janë në rritje të vazhdueshme dhe ka raste kur të ardhurat nga restorantet mbizotërojnë në strukturën e të ardhurave nga agroturizmi (modeli i biznesit "nga ferma në tryezë"). Fermat që rritin ose prodhojnë një larmi të gjerë të produkteve ushqimore mund t'i konsiderojnë tarifat e degustimit si pjesë të fluksit të të ardhurave të agroturizmit. Meqenëse këto përvoja janë të rralla, vizitori shpesh është i gatshëm të paguajë shtesë për ofertën.

- **Tarifa e shëtitjes në fermë**

Tarifa e shëtitjes në fermë i vë në dispozicion vizitorit shërbimet e një udhërrëfyesi të informuar ose të paktën një udhëzues për shëtitjet që mund t'i organizojë vetë. Tarifat mesatare të shëtitjeve janë rreth 10-15 euro për person. Një turist që paguan këtë tarifë dëshiron informacion dhe akses në hapësirat e fermës që janë të kufizuara për vizitorët e tjerë. Pas pagimit të tarifës, ferma do ta pajisë vizitorin me biletë ose kartë që tregojnë statusin e tij si pjesëmarrës që ka paguar për shëtitjen. Përveç shëtitjeve në fermë, njësitë e agroturizmit mund të ofrojnë programe vizitash në zonat përreth, vizita në atraksionet natyrore dhe pika të tjera me interes. Shëtitjet e vetëorganizuar janë përgjithësisht falas; megjithatë, shëtitjet në grup shpesh kërkojnë shumë kohë që stafi të përgatitet dhe të organizojë shëtitjen.

- **Shitjet e produkteve të freskëta të fermës te një bazë më e gjerë klientësh**

Përmes shitjeve direkte, fermat sigurojnë tregun për një pjesë të produkteve të tyre të freskëta. Këto produkte i shiten një baze më të gjerë klientësh me çmime pakice. Kjo sjell të ardhura më të larta nga aktiviteti bujqësor, si dhe marzhe më të mira fitimi.

- **Shitjet e produkteve bujqësore të përpunuara**

Shumë ferma janë zgjeruar duke prodhuar dhe shitur artikuj me vlerë të shtuar. Produktet e përpunuara, të tilla si reçeli, turshitë dhe frutat e thata, janë shpesh artikuj më të mirë pakice për vizitorët, pasi ato janë lehtësisht të transportueshme. Shitjet e këtyre produkteve rriten kur vizitorët e provojnë vetë produktin gjatë qëndrimit në fermë.

- **Shitja e produkteve artizanale/suvenireve**

Përveç shitjes së produkteve të fermës, pronarët e fermave mund të përfitojnë nga shitja e suvenireve, të tilla si ornamentet, sendet e punuara me dorë dhe objektet antike rurale. Shumë operatorë agroturizmi në të gjithë botën kanë zgjeruar veprimtarinë me dyqanet e dhuratave, por kjo kërkon inventarizim dhe madje edhe më shumë menaxhim. Ky mund të jetë një investim i justifikuar, por vetëm pasi ferma të tërheqë një numër të konsiderueshëm vizitorësh. Blerja e këtyre produkteve nga bizneset e tjera rurale për t'i shitur me një marzh fitimi do të sigurojë të ardhura jo vetëm për fermën, por edhe për komunitetet rurale përreth.

- **Tarifa e aktiviteteve në fermë**

Turistët që vizitojnë fermat shpesh janë shumë të interesuar të marrin pjesë në aktivitetet e përditshme të fermës. Shpeshherë turistët janë të gatshëm të paguajnë për të provuar për një ditë jetën e një fermeri. Kjo siguron një mundësi për krijimin e të ardhurave shtesë. Disa shembuj të veprimtarive për të cilat fermat mund të aplikojnë tarifa janë: aktivitetet e ushqyerjes së kafshëve; udhëtimi me qerre; seancat e kalërimit; udhëtimet nëpër fushë apo plantacione, punimi i tokës etj. Ferma mund të vendosë një tarifë 10-20 euro për person për ofrimin e këtij lloji aktiviteti.

- **Tarifa e edukimit dhe zhvillimit të aftësive**

Mundësitë e turizmit edukativ janë në rritje sepse shumë turistë preferojnë të qëndrojnë aktivë dhe mendërisht të angazhuar edhe kur janë me pushime. Shumë banorë dhe fqinjë do të përfitojnë gjithashtu nga orët mësimore që do të zhvillojë ferma. Nuk ka kufizime praktike në orët mësimore që mund të ofrojë ferma. Disa shembuj përfshijnë: fermat e drithit mund të organizojnë orë mësimore për pjekjen e bukës; fermat me drejtim frutikulturë mund t'u tregojnë vizitorëve se si të bëjnë reçel, marmelatë ose shurup frutash; fermat me drejtim vreshtarinë mund të organizojnë orë mësimore mbi prodhimin e verës dhe përzierjen e saj etj. Fermat e agroturizmit duhet ta konsiderojnë këtë aktivitet si një burim të mirë të ardhurash ndërsa zhvillojnë ofertën e tyre të agroturizmit.

- **Tarifa e pjesëmarrjes në evente**

Vendoset një tarifë hyrjeje për të marrë pjesë në evente dhe aktivitete, ose për shëtitje në zona të veçanta të veprimtarisë në fermë. Fermat nuk duhet të vendosin tarifë për hyrjen në një zonë të shitjes me pakicë të produkteve (si p.sh. dyqani i produkteve të fermës), por në një pjesë më të kufizuar të fermës, siç është hyrja në një platformë shikimi në sallën e mjeljes. Zakonisht aplikohet një tarifë e përgjithshme hyrjeje, në vend të tarifave të tjera, si tarifa e shëtitjes ose veprimtarisë.

3.6. KONSIDERATA ZHVILLIMORE PËR TË SIGURUAR RRRITJEN E QËNDRUESHME TË AGROTURIZMIT

Çdo iniciativë për zhvillimin e produkteve në sektorin rural dhe agroturizëm duhet të përcaktojë qëllimet për të tërhequr sa më shumë turistë nga tregjet e reja, për të siguruar kohëqëndrim më të gjatë dhe për të rritur shpenzimet e secilit vizitor.

Një ofertë e diversifikuar rrit mundësinë e tërheqjes së turistëve me interes të veçantë. Zhvillimi i agroturizmit duhet të sigurojë përfitime për popullsinë rurale dhe të ruajë peizazhet tradicionale rurale dhe biodiversitetin. Ekzistojnë disa iniciativa zhvillimore në nivelin privat dhe publik që do të transformonin sektorin nëse aplikohen në përputhje me rrethanat.

Në nivelin privat, sipërmarrjet e agroturizmit duhet të krijojnë një ndërthurje unike të akomodimit dhe përvojave, në bashkëpunim me ofruesit lokalë të turizmit rural. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi mes fermave janë thelbësore për suksesin: krijimi i produktit, marketingu, standardet e shërbimit, mësimi, mbështetja logjistike, shërbimet reciproke - motori i sigurimit dhe prenotimit. Sektori privat duhet t'i nxisë komunitetet rurale që të marrin në dorë zhvillimin, menaxhimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive dhe vendndodhjeve rurale.

Në nivelin publik, agjencitë përkatëse të planifikimit dhe hartimit të politikave duhet të identifikojnë pasuritë rurale të pashfrytëzuara ose të bollshme dhe të hartojnë strategji për t'i përdorur ato. Ka shumë rëndësi nxitja e vetëpunësimit dhe motivimi i të rinjve që të qëndrojnë në zona rurale. Ekziston nevoja për të nxitur prodhimin e ushqimit organik dhe shitjen e tij nëpërmjet infrastrukturës së turizmit. Vëmendje duhet t'i kushtohet pamjes tradicionale të banesave familjare, mbështetjes për rindërtimin dhe restaurimin e pasurive të vjetra tradicionale, d.m.th. fshatrave dhe katundeve, dhe për t'i bërë ato ekzistuese të duken sa më shumë tradicionale. Futja e licencimit mund të përmirësojë nivelin e cilësisë së akomodimit, hotelierisë dhe turizmit. Për sa i përket krijimit të kërkesës, është shumë e rëndësishme që të rritet ndërgjegjësimi, mirëkuptimi dhe shijimi i produkteve dhe përvojave që gjenden në njësitë e agroturizmit dhe zonat rurale.

4. ANALIZA SWOT E SEKTORIT TË AGROTURIZMIT

Ndërsa agroturizmi në Shqipëri është ende një sektor në zhvillim megjithëse ka potencial të madh për të ardhmen, analiza SWOT do të ishte një kuadër i dobishëm për të analizuar pikat e forta dhe të dobëta të sektorit, si dhe mundësitë dhe kërcënimet. Kjo e ndihmon sektorin që të përqendrohet në pikat e forta, të punojë me pikat e dobëta, të minimizojë kërcënimet dhe të shfrytëzojë mundësitë e disponueshme.

Zhvillimi i agroturizmit në Shqipëri përfiton nga një sërë **pikash të forta** dhe pritet të pësojë rritje të shpejtë duke përfutur nga **mundësitë** e shumta. Shqipëria është një vend bujqësor, me pozicion të mirë gjeografik, me një natyrë të jashtëzakonshme piktoreske, e pasur me atraksione turistike dhe me një traditë të lashtë të mikpritjes. Sektori i agroturizmit është sektor me prioritet të lartë në programin e qeverisë dhe ka tërhequr interesin e agjencive donatore.

Është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët në zinxhirin e vlerës të agroturizmit të punojnë në drejtim të reduktimit të **pikave të dobëta** të sektorit dhe minimizimit të efekteve të mundshme negative të **kërcënimeve** ekzistuese ose të ardhshme. Ekziston një mungesë e përgjithshme përvoja dhe mungesë e aftësive të menaxhimit të biznesit në këtë sektor. Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për të ulur nivelin e informalitetit, e nevojshme kjo për ta bërë sektorin të pranueshëm për programe të ndryshme grantesh dhe të kualifikueshëm për kredi tregtare. Ekziston një fokus i ulët i institucioneve financiare në sektorin e agroturizmit, prandaj duhet të prezantohen stimuj për t'i motivuar që ta konsiderojnë agroturizmin në portofolin e tyre.

Disa zhvillime mund të ndikojnë negativisht në performancën e sektorit. Aktualisht, paqëndrueshmëria politike paraqet një kërcënim të madh jo vetëm për agroturizmin, por për të gjithë sektorin e turizmit në Shqipëri. Kërcënime të tjera ndaj sektorit përfshijnë tendencën në rritje të të rinjve për t'u larguar nga zonat rurale, keqmenaxhimin e mbetjeve dhe problemet e të drejtave pronësore, të cilat mund të pengojnë investimet në sektor.

Në tabelën 3 më poshtë paraqitet një analizë e hollësishme SWOT, e cila është bazuar në shqyrtime të literaturës dhe konsultime të hollësishme me sipërmarrës të agroturizmit dhe ekspertë të turizmit.

Tabela 3: Analiza SWOT e sektorit të agroturizmit në Shqipëri

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhja e jashtëzakonshme gjeografike Natyra e bukur dhe e larmishme (bregdet, liqene, lumenj, laguna, male, kodra, ujëvara) E pasur me atraksione kulturore dhe site arkeologjike (shumica e tyre ndodhen në zonat rurale bujqësore). Vend bujqësor (më shumë se 300.000 ferma); Tradita e vjetër e mikpritjes; Oferta e pasur e kulinarisë dhe gastronomisë me shumë gatime tradicionale (secili rajon ka gatimet e veta tradicionale); Gama e gjerë e produkteve tradicionale (po zhvillohen inkubatorë të produkteve tradicionale); Shërbimet me kosto të ulët; 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e përvojës dhe aftësive të menaxhimit të biznesit në agroturizëm; Niveli i ulët i arsimimit të popullsisë rurale dhe cilësia e dobët e arsimit në zonat rurale Fokusi i ulët i bankave dhe institucioneve financiare në financimin e sektorit; Mungesa e një strategjie kombëtare për zhvillimin e agroturizmit; Mungesa e një studimi të zinxhirit të vlerës së sektorit; Infrastruktura e dobët rrugore dhe transporti i dobët publik në zonat rurale; Mungesa e programeve të përshtatshme të trajnimit për menaxhimin e agroturizmit. Niveli i lartë i informalitetit të sektorit të bujqësisë; Marketingu nuk është në nivel të lartë, veçanërisht promovimi;
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> Dhënia e prioritetit të lartë në programin e qeverisë (programi "100 fshatrat"; fokus i rëndësishëm në strategji të ndryshme zhvillimi); Disponueshmëria e fondeve për investime të ofruara nga programe të ndryshme grantesh (AZHBR, IPARD, të tjera) Fokusi më i madh nga agjencitë donatore (USAID, GIZ, BE, Bashkëpunimi Zviceran, qeveria suedeze); Kërkesa në rritje për përvojë agroturistike si nga turistët vendas, edhe nga ata të huaj; (rreth 50% e popullsisë shqiptare jetojnë në zona urbane; 54% e popullsisë botërore jetojnë në zona urbane); Përshtatshmëria për agroturizëm gjatë gjithë vitit; 	<ul style="list-style-type: none"> Problemet me të drejtat pronësore mund të pengojnë investimet (dokumentacioni i tokës është kriter i rëndësishëm për të përfutur nga programi i grantit ose marrja e një kredie tregtare); Keqmenaxhimi i mbetjeve në zonat rurale. Paqëndrueshmëria politike mund të dëmtojë imazhin e vendit dhe të rezultojë në një numër të ulët turistësh. Tendenca në rritje e të rinjve për t'u larguar nga zonat rurale për një jetë më të mirë në qytetet e mëdha.

Burimi: Kërkim dytësor dhe konsultime me ekspertë

5. NEVOJAT E FINANCIMIT TË AGROTURIZMIT

Si në shumë sektorë të tjerë, mundësitë e financimit janë thelbësore për zhvillimin e agroturizmit. Mes arsyeve të tjera, mundësitë e pakta të financimit konsiderohen një pengesë serioze për rritjen e sektorit të agroturizmit. Pavarësisht interesit në rritje për të investuar në agroturizëm, ende ka probleme në përputhjen e kërkesës me ofertën e kapitalit në këtë sektor. Për të zhvilluar sektorin e agroturizmit në mënyrë më gjithëpërfshirëse, mundësitë e granteve dhe stimujt fiskalë duhet të kombinohen me gatishmërinë e institucioneve financiare për të financuar sektorin me produkte kredie të përshtatura sipas nevojave dhe specifikave të tyre.

Bazuar në tendencat e fundit të investimeve dhe parashikimet e rritjes, agroturizmi në të ardhmen e afërt paraqet një mundësi të shkëlqyer në treg për bankat dhe institucionet financiare. Vitet e fundit, në sektorin e agroturizmit janë zbatuar investime me vlerë rreth 10 milion euro, të stimuluar nga skema të ndryshme grantesh, siç janë skemat kombëtare të AZHBR-së, SARED etj. Vlera e investimit është më e lartë nëse përfshijmë nismat e investimeve private, që janë më të vështira për t'u matur. Bazuar në këto tendenca dhe duke marrë parasysh mundësitë e disponueshme në sektor (grantet e IPARD dhe AZHBR-së, programin "100 fshatrat", programet dhe projektet e tjera mbështetëse), gjatë 5-7 vitet e ardhshme pritet një vlerë e rëndësishme investimesh të reja e përllogaritur në rreth 50 - 70 milionë euro. Bazuar në projekte të tilla si projekti CEED Albania për agroturizmin, kthimi i një shtëpie të vjetër ferme në bujtinë do të kërkonte rreth 10,000-25,000 euro. Investimet e vogla janë tipike në zonat e thella malore në Dibër, Kukës, Shkodër etj, ku familjet rurale i shndërrojnë banesat e tyre të vjetra në bujtina me qëllim që të krijojnë të ardhura shtesë dhe t'i shtojnë vlerë produkteve të tyre bujqësore.

Një investim i mesëm mund të konsiderohet një investim në vlerën 100,000 - 300,000 euro. Këto investime zakonisht kryhen nga biznesmenët dhe kuzhinierët me përvojë në menaxhimin e hotelarisë, të cilët kanë një lidhje të caktuar me zonën në të cilën po investojnë. Investimet në shkallë mesatare priten në zonat ku agroturizmi i shtohet ofertës ekzistuese të turizmit. Këtu përfshijmë Gjirokastrën, Berat, Korçën, Vlorën etj.

Investimet e mëdha mund të fillojnë nga 300,000 euro + dhe të arrijnë në miliona euro. Këto lloj investimesh zakonisht ndërmerren nga sipërmarrës të njohur nga industri të tjera, të cilët duan të diversifikojnë portofolin e tyre duke investuar në agroturizëm. Kohët e fundit ka pasur një interes të dukshëm për të bërë investime më të mëdha në agroturizëm nga investitorë të huaj (kryesisht investitorë italianë dhe grekë). Investime të mëdha ka më shumë të ngjarë të ndodhin në Shqipërinë e Mesme, për shkak të përqendrimit të lartë të kapitalit dhe popullsisë së madhe urbane që kërkojnë përvoja rurale.

5.1. PRODUKTET FINANCIARE EKZISTUESE PËR AGROTURIZMIN NGA BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE NË SHQIPËRI

Aktualisht, sektori po përfiton nga grante të pakthyeshme të ofruara nga skemat kombëtare të AZHBR-së dhe IPARD II dhe do të përfitojë nga programi "100 fshatrat", i cili do të ofrojë fonde dhe asistencë teknike. Sidoqoftë, sektori i agroturizmit ka marrë shumë pak vëmendje nga bankat dhe

institucionet financiare. Kërkesa për kredi për investime pritet të rritet me shpejtësi në agroturizëm dhe bankat dhe institucionet financiare duhet të përgatiten me produkte të dedikuara për të përmbushur këtë kërkesë në rritje.

Intesa San Paolo është një nga IFP-të më të rëndësishme që ka shprehur gatishmërinë e saj për të mbështetur sektorin e agroturizmit në Shqipëri dhe ka ndërmarrë disa veprime konkrete në këtë drejtim. Banka ka zhvilluar katër produkte kredie specifike për agroturizmin: 1) Kredi për investime për ndërtimin dhe/ose rindërtimin e objekteve akomoduese të agroturizmit dhe blerjen e makinerive; 2) kredi për investime në makineri dhe pajisje për të rritur cilësinë dhe larminë e produkteve tipike tradicionale në mbështetje të agroturizmit; 3) kredi për investime për ndërtimin e restoranteve të agroturizmit ose rindërtimin e objekteve ekzistuese për të ofruar shërbime hotelierie; dhe 4) kapital qarkullues për të mbuluar nevojat e përkohshme të likuiditetit. Për të garantuar menaxhim të mirë të performancës dhe për të mbështetur biznesin e ri, banka i ka përfshirë aktivitetet e kreditimit për agroturizmin te Treguesit Kryesor të Performancës të forcës së saj të shitjes në degë.

Banka Credins ka zhvilluar një produkt kredie të përshtatur për agroturizmin, të quajtur "Agroturizmi 100". Banka është gjithashtu partnere në një fushatë ndërgjegjësuese për "agroturizmin si një potencial për zhvillimin rural" së bashku me MBZHR-në, Universitetin e Firences dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës. Në këto seminare ndërgjegjësuese, përfaqësuesit e Bankës Credins prezantojnë produktet e Agroturizmi 100 dhe shprehin gatishmërinë e tyre për të financuar sektorin e agroturizmit. Sidoqoftë, agroturizmin e përfshijnë ende në segmentin e bujqësisë.

Fondi Besa aktualisht ofron kredi të vogla për bizneset turistike rurale, një produkt i financuar nga "CESVI Albania" në kuadër të projektit "Zana e Maleve". Objektivi përfshin të rinjtë e moshës 18-35 vjeç me ide për të investuar në turizmin rural dhe agroturizmin.

Në vitin 2018, **NOA**, një institucion i rëndësishëm mikrofinanciar në Shqipëri, promovoi një produkt kredie kushtuar turizmit, më saktësisht turizmit bregdetar, rural/agrar dhe kulturor. Për turizmin rural dhe agroturizmin, produkti është i destinuar për rindërtimin e banesave të vjetra të fermave, duke përfshirë të gjithë mobilimin e nevojshëm, si dhe rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve të agroturizmit. NOA ofron gjithashtu disa stimuj për klientët potencialë të agroturizmit, duke vendosur norma më të ulëta interesi krahasuar me sektorët e tjerë.

Në përgjithësi, ka ende shumë pak iniciativa për financimin e agroturizmit nga bankat dhe institucionet financiare. Me përjashtim të iniciativave të lartpërmendura, bankat dhe institucionet financiare nuk e trajtojnë agroturizmin si sektor më vete, por e përfshijnë atë në portofolin e bujqësisë. Në përgjithësi, pavarësisht ndërgjegjësimit të rritur për potencialin e agroturizmit, institucionet financiare nuk po e konsiderojnë atë si një dritare të re në treg që meriton zhvillimin e një strategjie kreditimi specifike dhe të mirë menduar.

5.2. NEVOJAT FINANCIARE TË SEKTORIT TË AGROTURIZMIT

Bazuar në tendencat e fundit dhe zhvillimet e pritshme, njësitë e agroturizmit (do të kenë) kanë nevojë për kapital për investimet/ndërhyrjet e mëposhtme:

Rikonstruksioni i banesave të vjetra. Shumica e fermave dhe agrobizneseve janë biznese familjare që kanë vite që merren me biznes bujqësor. Ndërgjegjësimi i shtuar në të gjithë vendin për agroturizmin si një mundësi për të ardhura shtesë ka nxitur shumë njësi bujqësore që të përdorin

shtëpitë e tyre të vjetra tradicionale si bujtina me fjetje dhe mëngjes. Pritet një rritje e kërkesës për kredi për investime në lidhje me rikonstruksionin dhe mobilimin e shtëpive të vjetra për t'i shndërruar ato në bujtina në fermë.

Ndërtimi i objekteve akomoduese dhe restoranteve në stil tradicional me gatime dhe produkte ushqimore tradicionale. Një tendencë në rritje në sektorin e agroturizmit janë investimet në biznese plotësisht të reja të agroturizmit. Biznesmenët dhe kuzhinierët me përvojë në menaxhimin e hotelerisë janë duke investuar në sektorin e agroturizmit duke ngritur njëherazi ferma dhe objekte të agroturizmit. Investitorët nga sektorët e tjerë po tregojnë gjithashtu interes për të investuar në biznese të tilla krejtësisht të reja të agroturizmit. Kërkesa për kredi për të investuar në ndërtimin e objekteve akomoduese dhe restoranteve për qëllime agroturizmi pritet të pësojë rritje të shpejtë në vitet në vijim.

Linjat e përpunimit dhe paketimit/etiketimit në fermë. Shumë ferma që e përshtatin aktivitetin e tyre bujqësor në agroturizëm do të duhet të investojnë në linjat e përpunimit në fermë. Turistët e mundshëm në kërkim të një përvoje agroturizmi presin të shijojnë ushqimin dhe gatimet tradicionale që ferma duhet të ofrojë dhe jo menutë standarde që gjenden në restorantet urbane. Thënë kjo, fermat do të duhet të investojnë në impiantet dhe makineritë e përpunimit në fermë. Disa nga investimet përfshijnë baxho të vogla, kantina të vogla dhe dhoma të degustimit të verës, linja të përpunimit të ullirit etj. Prodhimet tradicionale të përpunuara preferohen shumë nga turistët e huaj që kërkojnë përvoja agroturizmi (gliko, reçel, lëngje, fruta të thata etj.). Produktet e përpunuara mund të shërbehen në restorant, si dhe t'u shiten direkt vizitorëve.

Pikat e shitjes në fermë ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të promovuar produktet e fermës para turistëve dhe për të realizuar shitje direkte me një çmim më të lartë. Për t'i shitur direkt produktet e përpunuara, fermat duhet të investojnë në teknologjinë e paketimit dhe etiketimit, në mënyrë që të shesin vaj ulliri dhe verë të një marke të caktuar, produkte të qumështit të paketuara, gliko ose reçel në kavanoza etj. Bizneset e agroturizmit do të duhet të investojnë në blerjen e pajisjeve sportive dhe rekreative. Për një përvojë gjithëpërfshirëse turistike, njësitë e agroturizmit duhet të investojnë në infrastrukturë dhe pajisje për ofrimin në terren të shërbimeve të turizmit, duke përfshirë rrugë të brendshme për të mbërritur në objektet akomoduese, park lojërash për fëmijë, pishina, kënde sportive etj. Ndonjëherë këto lloj investimesh janë pjesë e gjithë projektit të agroturizmit. Ka edhe raste me biznese të ngritura të agroturizmit që duan të investojnë për zgjerimin e ofertës së shërbimeve.

Investimet për të zhvilluar aktivitete agroturizmi. Turistët mund të duan të marrin pjesë në disa aktivitete brenda një dite të vetme. Aksesueshmëria dhe disponueshmëria e aktiviteteve sa më pranë janë tipare të rëndësishme të bizneseve të agroturizmit (Eilliams et al. 2011). Si rrjedhojë, bizneset e agroturizmit, për t'iu përshtatur pritshmërive të konsumatorit, mund të duhet të investojnë në zhvillimin e aktiviteteve të agroturizmit, të tilla si kalërimi, bletaria, kopshtet zoologjike me kafshë shtëpiake etj.

Certifikimet dhe standardet e cilësisë. Turistët në të gjithë botën po bëhen gjithnjë e më të ndjeshëm ndaj zbatimit të praktikave të mira bujqësore, cilësisë dhe sigurisë së produkteve dhe ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Rreth 64% e evropianëve dëshirojnë pushime më shumë "ekologjike". Rekomandohet që agroturizmi të shpenzojë para për marrjen e licencave dhe certifikatave.

Standardi për certifikimin e bizneseve të agroturizmit është vendosur dhe miratuar me VKM nr. 22, datë 12.1.2018. Ky certifikim u mundëson bizneseve të agroturizmit të përfitojnë nga stimujt fiskalë dhe të drejtën e përdorimit të termit Agroturizëm në emërtimin e biznesit. Ekzistojnë gjithashtu shumë certifikime produkti, si manuali HACCP, Organik, Global GAP, ISO etj.

Bizneset e Agroturizmit do të duhet të investojnë në zhvillimin e standardeve të cilësisë në agroturizëm - miratimin e ISO për sigurimin e mjedisit dhe të cilësisë, higjienës dhe standardeve të tjera, si dhe zhvillimin e një programi të sigurimit të cilësisë. Zhvillimi i programeve të sigurimit të cilësisë dhe marrja e çertifikimit të standardeve të cilësisë, kërkon ekspertizë profesionale, kohë dhe para, të cilat shumë ferma të vogla nuk i kanë. Bankat dhe institucionet financiare rekomandohen të zhvillojnë produkte të dedikuara kredie për të adresuar këtë nevojë jetike për sektorin.

Promovimi dhe investimet në marketing. Pas krijimit të një biznesi agroturizmi, ekziston një nevojë jetike për marketing dhe promovim për të garantuar suksesin. Turistët nuk vijnë krejt papritur. Sipërmarrësit e agroturizmit duhet t'i informojnë klientët se ku është ferma dhe se si do të përfitonin po ta vizitonin. Nëse biznesi i agroturizmit reklamohet mirë, shanset për sukses do të përmirësohen. Bizneset e agroturizmit duhet të hartojnë një plan marketingu dhe të shpenzojnë para për disponueshmërinë dhe praninë e dukshme në internet (faqet e internetit, mediat sociale), reklamimin, prodhimin e broshurave dhe fletëpalosjeve dhe investimeve të tjera të marketingut. Shumica e fermave të vogla që janë kthyer në njësi agroturizmi nuk kanë mjaft likuiditet për të përballuar një fushatë marketingu dhe promovimi. Kreditë e dedikuara për marketingun dhe aktivitetet promovuese të bizneseve të agroturizmit paraqesin një mundësi të mirë në treg për bankat dhe institucionet financiare.

Në përgjithësi, ekziston një nevojë e lartë për investime, por sipas bankave dhe institucioneve financiare ekziston një kërkesë çuditërisht e ulët për kredi në fushën e agroturizmit. Kërkesa e ulët mund të jetë rezultat i aksesit të paktë në informacionin mbi produktet e bankës, perceptimin e normave të larta të interesit etj. Bankat, institucionet financiare dhe grupet e tjera të rëndësishme të interesit duhet të mbështesin dhe zhvillojnë iniciativa për krijimin e kërkesës, në mënyrë që të kapin mundësitë e tregut të ofruara nga sektori i agroturizmit.

5.3. RISQET KRYESORE TË LIDHURA ME BIZNESIN E AGROTURIZMIT

Agroturizmi konsiderohet një mundësi e shkëlqyer për diversifikimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, si çdo biznes tjetër, bizneset e agroturizmit përballen me disa rreziqe. Ekzistojnë gjashtë kategori kryesore risku që mund të jenë të pranishme për sipërmarrjet e agroturizmit. Risku juridik është ndoshta risku më i njohur, por bizneset e agroturizmit përballen edhe me riskun e burimeve njerëzore, riskun e ndërprerjes së biznesit, riskun e prodhimit, riskun e marketingut dhe riskun financiar⁵.

Risku ligjor. Ligjet dhe rregulloret e shtetit në lidhje me shëndetin dhe sigurinë publike; përdorimi dhe zhvillimi i tokës; licencat dhe taksat, mjedisi. Informacioni i kufizuar në lidhje me ligjet që rregullojnë sektorin mund të rezultojë në shkeljen e standardeve të caktuara në lidhje me shëndetin dhe sigurinë publike, mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e duhur të tokës, licencat dhe taksat etj. Gjithashtu, ky informacion i kufizuar mund t'i pengojë njësitë e agroturizmit që të përfitojnë fondet e granteve dhe stimujt fiskalë të ofruar nga qeveria shqiptare.

Risku i burimeve njerëzore. Në Shqipëri, shumica e sipërmarrjeve të agroturizmit janë biznese familjare. Rreziku i burimeve njerëzore është i lidhur me ndryshimet në familje që mund të

⁵ Megan L. Bruch - Departamenti i Bujqësisë Fitimprurëse - Universiteti i Tennessee

ndikojnë në menaxhimin e biznesit (vdekja, divorci, invaliditeti, mosmarrëveshja). Risku i burimeve njerëzore lidhet gjithashtu me personelin e punësuar. Nëse punonjësit nuk e kanë kuptuar qartë se çfarë duhet bërë për të qenë i suksesshëm, kjo mund të sjellë probleme në menaxhim dhe mund të ulë cilësinë e ofertës turistike në fermë.

Risku i ndërprerjes së biznesit. Humbja e të ardhurave për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike, fatkeqësive natyrore.

Risku i prodhimit. Sipërmarrjet e agroturizmit që përfshijnë ose mbështeten në prodhimin e produkteve bujqësorë, kulturave të veçanta ose produkteve të blegtorisë shpesh përballen me risqe të prodhimit. Kushtet e motit, sëmundjet ose insektet e dëmshme mund të ulin ose të çojnë në humbje të plotë të prodhimit. Siguria dhe cilësia e ushqimit mund të rrezikohet nga keqmenaxhimi i mbetjeve në zonat ku operon biznesi, gjë që rrit mundësinë e përhapjes së sëmundjeve ose patogjenëve mes kulturave, bagëtive ose produkteve.

Risku i marketingut. Mund të përfshijë paaftësinë për të tërhequr mjaftueshëm klientë, tërheqjen e më shumë klientëve nga sa mund të akomodohen për një përvojë cilësore, ose ndikimin negativ nga një burim i ri i konkurrencës.

Risku financiar. Ky risk lidhet me pamundësinë për të plotësuar nevojat e likuiditetit të parasë, marrjen e kapitalit të përballueshëm të borxhit, mirëmbajtjen ose rritjen e kapitalit në sipërmarrjen e agroturizmit, riskun e dëmtimit ose vjedhjes së pasurisë (e cila do të kërkonte investime të reja të paparashikuara).

5.3.1. Strategjia e zbutjes së riskut

Për të eliminuar ose zbutur risqet e lartpërmendura, sipërmarrësit e agroturizmit duhet të zhvillojnë sisteme gjithëpërfshirëse për menaxhimin e riskut dhe të përcaktojnë hapa konkretë për t'u ndjekur rregullisht. Lidhur me riskun juridik, menaxherët e njësive të agroturizmit duhet të kenë njohuri të mira të ligjeve dhe rregulloreve shtetërore në lidhje me sektorin, të kuptojnë sistemin e licencimit dhe taksimit dhe të zbatojnë në mënyrë rigoroz procedurat për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve. Është shumë e rëndësishme që pronarët e njësive të agroturizmit të kuptojnë plotësisht konceptin e agroturizmit dhe të lexojnë me kujdes VKM-në nr. 22, datë 12.1.2018 për "Miratimin e kriterëve për certifikimin e njësive të agroturizmit" dhe VKM-të nr. 711 dhe 730 për "Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese.

Risku i burimeve njerëzore mund të zbutet duke trajnuar rregullisht stafin mbi ofrimin e shërbimeve të agroturizmit, praktikën e mira bujqësore që duhet të ndiqen, aftësitë e menaxhimit të klientëve etj. Është shumë e rëndësishme që stafi të kuptojë strategjinë e biznesit që synon për t'i sjellë sukses njësisë së caktuar të agroturizmit.

Risqet e ndërprerjes së biznesit dhe prodhimit lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bujqësor në biznesin e agroturizmit. Për fat të mirë, kompanitë e sigurimeve më në fund po marrin në konsideratë bujqësinë në portofolin e tyre për produktet e sigurimit. Pra, një mundësi mund të jetë sigurimi i produkteve bujqësore, i cili do të nënkuptonte kosto shtesë për fermat, por do të ndihmonte në shmangien e humbjeve të mundshme financiare në të ardhmen. Sidoqoftë, duhet të shprehet qartë se vetë agroturizmi konsiderohet strategjia më e mirë e diversifikimit dhe e zbutjes së risqeve për çdo fermë dhe agrobiznes.

Trajtimi i riskut të marketingut kërkon planifikim të mirë të përpjekjeve të marketingut. Bizneset e agroturizmit kanë një nevojë thelbësore për marketing dhe promovim. Bizneset e agroturizmit

duhet të hartojnë një plan marketingu dhe të shpenzojnë para për të qenë të pranishme në internet (faqe interneti, media sociale), për reklamim, për prodhim të broshurave dhe fletëpalosjeve dhe për investime të tjera në marketing.

Zbutja e riskut financiar kërkon menaxhim të shëndoshë financiar të veprimtarisë së agroturizmit. Shtimi i veprimtarisë së turizmit në fermë rrit burimet e të ardhurave, por në të njëjtën kohë rrit kompleksitetin e menaxhimit financiar. Me rritjen e numrit të burimeve të të ardhurave, njësitë e agroturizmit duhet të planifikojnë dhe parashikojnë me kujdes të ardhurat në mënyrë që të shmangin mungesat në nevojat e likuiditetit të parave. Është shumë e rëndësishme të theksohet se agroturizmi pranohet gjerësisht nga politikëbërësit dhe ekspertët akademik mes strategjive më të mira të diversifikimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Agroturizmi duhet të konsiderohet gjithashtu si një strategji zbutëse për risqet e marketingut dhe risqet financiare të fermave dhe agrobizneseve.

Analizat e nevojave financiare dhe risqeve kryesore të lidhura me bizneset e agroturizmit duhet të ndihmojnë bankat dhe institucionet financiare në zhvillimin e strategjive të tyre të kreditimit për këtë sektor. Nevojat e ndryshme financiare të sektorit duhet të orientojnë bankat dhe institucionet financiare kur zhvillojnë produkte të dedikuara kredie për t'iu përgjigjur çdo nevoje. Ky informacion mund të jetë i rëndësishëm për departamentet e riskut të institucioneve financiare në zhvillimin e modeleve të vlerësimit për sektorin e agroturizmit.

5.4. POTENCIALET PËR KREDITIM DHE PRODUKTET E PROPOZUARA TË KREDISË PËR SEKTORIN E AGROTURIZMIT

Në Shqipëri, ka afërsisht 350.000 ferma dhe bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it, ekzistojnë rreth 142.000 ferma me më shumë se 1 ha tokë dhe rreth 49.000 ferma me më shumë se 2 ha, të cilat mund të shtojnë agroturizmin në veprimtarinë e tyre duke përfaqësuar një mundësi të shkëlqyer tregu për bankat dhe institucionet financiare. Shumica e tyre ndodhen në qarqet Vlorë, Fier, Korçë, Elbasan, Berat, Durrës dhe Tiranë.

Bazuar në intervistat me ekspertë të përfaqësuesve të MBZHR-së dhe NjQV-ve, në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 rretheve/qarqeve nënkupton 1.200 njësi të reja potenciale agroturizmi që presin mundësi investimi për tu hapur gjatë 5 deri në 7 vitet e ardhshme, çka përfaqëson një mundësi të shkëlqyer tregu për bankat dhe institucionet financiare.

Fragmentimi i lartë mbetet problem i madh, sepse i pengon fermat dhe agrobizneset të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës. Fermat që nuk janë në gjendje të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës për shkak të një sipërfaqeje toke të fragmentuar mund ta diversifikojnë aktivitetin duke shtuar ofertën e agroturizmit. Ndërsa madhësia mesatare e fermës konsiderohet e ulët për qëllime bujqësore, ajo hap mundësinë për zhvillimin e agroturizmit.

Kreditë për bujqësinë kanë pasur tendencë pozitive deri në tremujorin e tretë të vitit 2018. Ndërsa në tremujorin e katërt të vitit 2018 dhe në tremujorin e parë të vitit 2019 kreditë për bujqësinë arritën nivelin më të ulët të 3-4 viteve të fundit. Sektori i bujqësisë mbetet i nënfinancuar. Në vitin 2018, kreditë për bujqësinë përbënin vetëm 1,5% të totalit të kredive (BSH, 2018). Ndërkohë institucionet financiare jobankare po i kushtojnë vëmendje më të madhe bujqësisë. Rreth 12% e shumës totale të kredisë së Institucioneve Mikrofinanciare i është kushtuar sektorit të bujqësisë (BSH, 2018). Bankat dhe institucionet financiare e konsiderojnë sektorin me risk të lartë, ndërsa

fermerët dhe agrobizneset rëndisin mundësinë e financimit dhe koston e lartë të produkteve financiare mes tre pengesave kryesore për rritjen (BSH, 2017). Zhvillimi i sektorit të agroturizmit ka potencialin për të sjellë një tendencë pozitive në kreditimin e sektorit të bujqësisë. Fermat që kthehen në njësi të agroturizmit bëhen më tërheqëse për bankat dhe institucionet financiare.

Nuk ka të dhëna zyrtare në lidhje me destinacionin e kredive për bujqësinë, megjithatë, kreditë dhe fondet e granteve janë përdorur për mbjellje dhe teknologji për përmirësimin e rendimentit, ndërtimin e magazinave, përpunimin, makineri dhe pajisje paketimi dhe etiketimi, agregate dhe traktorë bujqësorë fabrika përpunimi etj. Pasuritë e luajtshme (makineritë, linjat e përpunimit, traktorët dhe automjetet e tjera) dhe ato të paluajtshme (toka, depo dhe shtëpi private) janë përdorur si kolateral për marrjen e kredive nga bizneset bujqësore. Të gjitha këto investime e kanë transformuar sektorin e bujqësisë në dhjetë vitet e fundit, duke siguruar një bazë të mirë për zhvillimin e agroturizmit.

Agroturizmi si një strategji për diversifikimin dhe për zbutjen e risqeve pritet të forcojë marrëdhëniet midis agrobizneseve dhe institucioneve financiare, të cilat duhet të përgatiten me produkte kredie të dedikuara për sektorin e agroturizmit. Më poshtë renditen disa produkte të propozuara kredie që mund të konsiderohen nga bankat dhe institucionet financiare.

Tabela 4: Produkt i propozuar kreditimi për sektorin e agroturizmit

Lloji i produktit	Kredi për zhvillimin e agroturizmit
Klientët e synuar	<ul style="list-style-type: none"> Sipërmarrjet e reja dhe ekzistuese të agroturizmit; Fermat dhe agrobizneset që shndërrohen në njësi agroturizmi; Ndërtimi i objekteve akomoduese përfshirë të gjitha pajisjet e nevojshme për mobilim; Rikonstruksioni dhe mobilimi i shtëpive të vjetra tradicionale në fermë për qëllime turizmi; Ndërtimi i ambienteve të shërbimit të ushqimit (restorante, furra buke, tenda për konsumimin e vakteve etj.)
Destinacioni/Qëllimi i kredisë	<ul style="list-style-type: none"> Blerja e pajisjeve sportive dhe rekreative; Rrugë dhe parkingje të brendshme etj. Linjat e përpunimit dhe paketimit në fermë; Zhvillimi i aktiviteteve të agroturizmit në fermë; çertifikimet e produkteve; Standardet e sigurimit të cilësisë; Aktivitetet e marketingut dhe promovimit;
Shuma e kredisë	Deri në 400,000 euro ose ekuivalenti i saj monedha të tjera Shuma e kredisë duhet të jetë e përshtatshme në bazë të nevojave të klientit dhe llojeve të investimeve
Monedha	ALL/EUR
Periudhë "Grace"	Po
Mënyra e shlyerjes	E c'rregullt (duhet të konsiderohet sezonaliteti i sektorit)
Periudha e shlyerjes	Deri në 15 vjet, për investime të mëdha E negociueshme, për nevoja të tjera të klientëve.
Lloji i sigurisë së kredisë	Kredi e pasiguar/siguar (Tokë, ndërtesa, pajisje, fonde garancie etj.) E pasiguar, për kredi deri në 15,000 Euro

* Bazuar në studimin tonë hulumtues, sektori nuk paraqet nevojë për kapital qarkullues, për shkak të natyrës së veprimtarisë pa stok të inventarit dhe pa të arkëtueshme. Kredia për investime është produkti i vetëm i ofruar nga IFP-të që u përgjigjet nevojave për investime të sektorit.

6. REKOMANDIME PËR PROMOVIMIN E POTENCIALEVE TË AGROTURIZMI PËR FINANCIM

Ky seksion ofron disa rekomandime të dobishme për IFP-të lidhur me iniciativat dhe aktivitetet e mundshme që duhet të merren parasysh për të përfituar nga potencialet e agroturizmit për zhvillim. Agroturizmi është një sektor në zhvillim, por një plan veprimi për promovimin e potencialeve të tij do të ishte i dobishëm për të kthyer nevojën për investime të reja në kërkesë për financim.

- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese të kombinuara me aktivitete për ngritjen e kapaciteteve me grupet përkatëse të interesit në lidhje me potencialet e sektorit për investime dhe mundësi financimi.
- Aktivitete në sektorin e agroturizmit duke bashkuar grupe të ndryshme interesi do të shërbente që sipërmarrësit e mundshëm të agroturizmit të kuptojnë kriteret e financimit dhe që bankat dhe institucionet financiare të mund të kuptojnë më mirë nevojat e sektorit për kapital.
- Lehtësimi i dialogut publik dhe privat duke u fokusuar në nismat e krijimit të kërkesës, siç janë fushatat ndërgjegjësuese për ato çka i bëjnë zonat rurale tërheqëse dhe strategjitë kombëtare promovuese të agroturizmit etj.
- Krijimi i sinergjive me projektet dhe iniciativat aktuale në sektorin e agroturizmit do të ishte i rëndësishëm për krijimin e një efekti të kombinuar më të mirë në misionin e përmirësimit të mundësive të financimit në sektorin e agroturizmit.

Edhe pse ekziston një nevojë e madhe për investime, evidentohet një kërkesë e ulët për kredi nga sektori i agroturizmit. IFP-të duhet të jenë më aktive dhe më bashkëpunuese për të zhvilluar dhe zbatuar aktivitete që do të rritnin kërkesën për kredi për investime nga sektori i agroturizmit. IFP-të e financojnë tashmë agroturizmin, por me kredi bujqësore. Sidoqoftë, zhvillimi i produkteve kredituese të dedikuara do të krijonte shanse më të mira për të akomoduar kërkesën e tregut dhe për të dhënë kredi të reja. Produktet e dedikuara të kredisë, të kombinuara me strategji specifike, do të mundësojnë një shfrytëzim optimal të potencialeve të sektorit për financim dhe investime të reja. Bankat dhe institucionet financiare duhet ta konsiderojnë rritjen e agroturizmit si një dritare të re në treg dhe ta trajtojnë atë si një segment të ri dhe të zhvillojnë një qasje specifike ndaj riskut të sektorit.

BURIMET E KONSULTUARA

- Qirici, E., dhe Theodhori, O. (2013). Menaxhimi i destinacionit si një mënyrë për zhvillimin konkurrues të turizmit. Rast studimor Krahina Jugore e Shqipërisë. *Revista rumune e ekonomisë dhe biznesit*, 8(2), 48.
- Demirović, D., Simat, K., & Radović, G. (2014). State Support for Development of Agritourism Entrepreneurship in AP Vojvodina (Serbia). *Tourism Education Studies and Practice*, (1), 11-22.
- Lattanzi, M. (2005). Creating Successful Agritourism Activities for your Farm. *South Deerfield, MA: Community Involved in Sustaining Agriculture (CISA)*, 36.
- Ochterski, J., & Roth, M. (2008). Getting started in agritourism. *Cornell Cooperative Extension*.
- Williams P, Paridaen M, Dossa K, Dumai M (2001). Agri-tourism market and product development status report. Ministria e Bujqësisë, Peshkimit dhe Ushqimit e Kolumbisë Britanike, Ministria e Biznesit të Vogël, Turizmit dhe Kulturës.
- Besra, N. 2018. Agritourism in Albania: Trends, Constraints, and Recommendations. *Qendra për Zhvillim Ekonomik në Universitetin e Harvardit*.
- Lattanzi, M. 2005. Creating Successful Agritourism Activities for Your Farm. Botuar nga *Community Involved in Sustaining Agriculture (CISA)* me mbështetjen e *USDA Rural Business Enterprise Grant*.
- Ministria e Bujqësisë dhe Turizmit - MTM, 2018. Shifrat e turizmit për vitin 2018.
- Agjencia Telegrafike Shqiptare, 2018. Artikull në internet në lidhje me ndikimin e skemës së granteve të AZHBR-së në krijimin e sipërmarrjeve të reja të agroturizmit.
- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 22, datë 12.1.2018. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për certifikatën "Biznes i certifikuar agroturizmi"
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimi dhe Integrim 2014-2020
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2022. Drafti.
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Udhëzuesi për aplikantët i IPARD II Thirrja e parë.
- Banka e Shqipërisë, 2019. Baza e të dhënave online, intervalet kohore e tendencave të kreditimit sipas sektorit.
- Banka e Shqipërisë, 2018. Raporti vjetor i mbikëqyrjes 2018.
- Banka e Shqipërisë, 2017. Raporti vjetor i mbikëqyrjes 2017.
- Projekti "Brand Albania". Krijimi i agroturizmit dhe turizmit. *Prezantim në seminar*.
- Platforma IntoAlbania – www.intoalbania.com
- Instituti i Statistikave i Shqipërisë (INSTAT) www.instat.gov.al

Intervistat

Nr.	Emri i plotë	Roli	Institucioni/kompania
1	Kamber Kasollari	Koordinator i Agrobiznesit	Credins Bank
2	Komola Sako	Përgjegjëse e CX dhe Marketingut Strategjik	OTP Bank
3	Blerta Selmanaj	Menaxhere e Zhvillimit të Produkteve për NVM-të	NOA
4	Elena Balliu	Përgjegjëse e Departamentit të Biznesit të Vogël	Intesa San Paolo
5	Irene Çela	Departamenti i NVM	FED Invest
6	Blerina Ago	Këshilltare	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
7	Rogert Huqi	Menaxher	Agroturizëm "Huqi"
8	Llesh Doçi	Pronari	Agroturizmi Oxhaku i Doçit

SHTOJCAT

Shtojca 1: Lista e njësive funksionale agroturistike në Shqipëri, 2018

Nr.	Emri i kompanisë	Personi i kontaktit:	Celular	Vendndodhja	Adresa	Kapacitetet akomoduese
1	Bujtina Pepushaj	Besnik Pepushaj	697890149	Shkodër	Lepushë,	10
2	Bujtina e Fratit	Gjovalin Pellumbaj	692250681	Shkodër	Kelmend	9
3	Agro ferma	Ahmet Sulejmani	673702456	Shkodër	Vermosh	6
4	"Kulla e Artë"	Fred Sterkaj	682071580	Shkodër	Nj.Ad. Ana e Malit	15
5	Bujtina Gëzimit	Gëzim Olaj	673036160	Shkodër	Razëm	10
6	Bujtina Tilaj	Vuk Tilaj	692064407	Shkodër	M. e Madhe, Bogë	10
7	Kunora	Nikoll Uka	682313943	Shkodër	M. e Madhe, Vermosh	6
8	Bujtina Zues	Jetmir Matlia	698504581	Shkodër	Qebik-Pukë	10
9	Hani- Përparimit	Përparim Laçi	682313943	Shkodër	Zues Rrethina	20
10	Bujtina Lumaj	Leonard Lumaj	693030733	Shkodër	Pukë	12
11	Dioniz Marku	Dioniz Marku	692908808	Shkodër	M. e Madhe, Vermosh	3
12	Bujtina Reç	Mirash Markaj	693198026	Shkodër	Guri i Zi	3
13	Mrizi i Zanave	Altin Prenga	692108032	Lezhë	M. e Madhe	3
14	Hylli Dritës	Fatmir Ndoj	698657614	Lezhë	Fishtë	2
15	Hani Lekës	Petrit Leka	674301029	Lezhë	Troshan	3
16	Agostin Luli	Agostin Luli	696905322	Lezhë	Troshan	10
17	Oazi	Angjelin Koleci	674656556	Lezhë	Tale	2
18	Syni Zi	Luc Lari	673889387	Lezhë	Fishtë	5
19	Brillanti	Rakip Haxhia	684010702	Lezhë	Shëngjin	6
20	Natyra	Gjergj Marku		Lezhë	Patog	4
21	Marubi	Gjovalin Prenga	682077420	Lezhë	Skuraj	6
22	Bujtinat e Kroit të Bardhë	Zef Lleshi	688401194	Lezhë	Rubik	3
23	"Haxhia"	Sejran Haxhia	682938357	Kukës	Kroi i Bardhë	8
24	"Selimaj"	Adem Selimaj	673380014	Kukës	Fshati Shishtavec	10
25	"Rilindja"	Alfred Selimaj	673014637	Kukës	Valbonë-Tropojë	12
26	"Natyra"	Avdi Selimaj	673093202	Kukës	Valbonë-Tropojë	8
27	Bujtina Gjana	Diloman Gjana	682595300	Kukës	Valbonë-Tropojë	16
28	Bujtina Shtini	Jeton Shtini	682597727	Kukës	Kukës	8
29	Stani i Hoxhës	Gezim Basha	674488884	Kukës	Kukës	16
30	Jezerca		673093406	Kukës	Kukës	14
31	"Selimaj"		686815704	Kukës	Valbonë-Tropojë	16

32	Relax		683502088	Kukës	Valbonë-Tropojë	14
33	Floresha Zëre	Floresha Zëre		Korçë	Voskopojë	
34	Prashqevi Çobani	Prashqevi Çobani	692699375	Korçë	Tushemisht	
35	Nazif Jolldashi	Nazif Jolldashi		Korçë	Tushemisht	
36	Anton Falo	Anton Falo	683369436	Korçë	Voskopojë	
37	Elza Tili	Elza Tili	694795333	Korçë	Tushemisht	
38	Ilo Todor	Ilo Todor	682604383	Korçë	Zaroshkë	
39	Anila Llakmani	Anila Llakmani	692264127	Korçë	Tushemisht	
40	Thoma Lena	Thoma Lena		Korçë	Boboshticë	
41	Astrit Musli	Astrit Musli	692494670	Korçë	Lin	
42	Kristaq Roça	Kristaq Roça		Korçë	Drenovë	
43	Dafina Beqiraj	Dafina Beqiraj	697625035	Korçë	Pirg	
44	Nikoleta Kita	Nikoleta Kita		Korçë	Vithkuq	
45	Alketa Melko	Alketa Melko	692316832	Korçë	Boboshticë	
46	Agim Bulka	Agim Bulka		Korçë	Voskopojë	
47	Klodiana Deda	Klodiana Deda	692593192	Korçë	Boboshticë	
48	Spiro Shkodrani	Spiro Shkodrani	682094104	Korçë	Voskopojë	
49	Marie Pleqi	Marie Pleqi		Korçë	Voskopojë	
50	Miranda Seferi	Miranda Seferi		Korçë	Dardhë	
51	Ilo Todor	Ilo Todor		Korçë	Liçenas	
52	Krenar Bregu	Krenar Bregu		Korçë	Leminot	
53	Oliver Pleqi	Oliver Pleqi		Korçë	Voskopojë	
54	Mimoza Rënxa	Mimoza Rënxa	682912026	Korçë	Vithkuq	
55	Llazar Lera	Llazar Lera		Korçë	Voskopojë	
56	Qamil Avdulla	Qamil Avdulla	692828338	Korçë	Lin	
57	Gerald Grabocka	Gerald Grabocka	692989345	Korçë	Vithkuq	
58	Tre Bujtinat		699205805	Elbasan	Gjinar	22
59	Alvaro Kadiu	Alvaro Kadiu		Berat	Mangalem	
60	Ferdinand Vruhu	Ferdinand Vruhu		Berat	Mangalem	
61	Redian Baci	Redian Baci		Berat	Mangalem	
62	Niko Droboniku	Niko Droboniku		Berat	30 Vjetori	
63	Silvja Meçaj	Silvja Meçaj		Berat	Mangalem	
64	Edmir Hidersha	Edmir Hidersha		Berat	Goricë	
65	Diamanta Bajrami	Diamanta Bajrami		Berat	Kala	
66	Remi Berberi	Remi Berberi		Berat	Iliria	
67	Enis Haxhijaj	Enis Haxhijaj		Berat	Muzakaj	
68	Ela Dingo	Ela Dingo		Berat	Çlirim, Berat	
69	Alfred Fiska	Alfred Fiska		Berat	Roshnik	
70	Vasilika Gogu	Vasilika Gogu		Berat	Mangalem	
71	Qemal Alushi	Qemal Alushi	682036634	Tiranë	Prezë	4
72	Hajdar Kuçi	Hajdar Kuçi	682026856	Durrës	Marikaj	3
73	Zeqir Mustafaj	Zeqir Mustafaj	672084777	Tiranë	Mucaj	0

74	Rahman Harizaj	Rahman Harizaj	682273916	Tiranë	Fushas	0
75	Resort "Nano"	Kliti Nano	672030193	Tiranë	Petrelë	
76	Adrian Tufa	Adrian Tufa	692036722	Tiranë	Lundër	0
77	Enver Sheshi	Enver Sheshi	686021828	Tiranë	Farkë	0
78	Uka Farm	Flori Uka	672039909	Tiranë	Laknas	0
79	Blerina Farm	Blerina Bombaj	42248981	Tiranë	Domje	0
80	Agroturizëm Huqi	Gezim Huqi	675099909	Durrës	Radë	6
81	Agroturizëm "Pema e jetës"	Gentiana Sinjari	692095398	Durrës	Shkallnur	0
82	Agroturizëm "Popi"	Shpëtim Dama	682021295	Durrës	Kuraten	0

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Shtojca 2: Lista e bizneseve të çertifikuara të agroturizmit në Shqipëri

Nr.	Emri i kompanisë	Celular	Email	Adresa	Kapacitetet akomoduese
1	Alfred Fiska P.F.	0682091617	alpetëinery@gmail.com	Roshnik-Berat	8
2	Albina Çuko P.F.	0692105543	albinacuko1@gmail.com	Shën-Gjergj, Tiranë	6
3	Qafshamë sh.p.k.		info@shkreliresort.al	Qafshamë, Krujë	25
4	Kol Marku P.F.	0684652952	ari_al85@hotmail.com	Katund i Vjetër, Mirditë	6
5	Qemal Alushi P.F.	0682036634	alushiolsi87@gmail.com	Prezë, Tiranë	6
6	Shqipe Huqi P.F.	0684099909	agroturizmi.huqi@gmail.com	Radë, Durrës	6
7	Libonike Nurellari P.F.	0695262940	fatosnurellari@yahoo.com	Peshtan, Poliçan	6
8	Agro Gjepali sh.p.k.	0684370437	fundimgjepali@gmail.com	Gjepalaj, Shijak	6
9	Altin Prenga P.F.	0696555252	altinprenga@hotmail.it	Fishtë, Lezhë	9
10	Kodra e Kuajve sh.p.k.	0696090081	kodra_kuajve@yahoo.com	Kodra e Dedejve, Durrës	18
11	Gramozi BR sh.p.k.	0682297081	gramozibr@gmail.com	Poshnje, Berat	7
12	Our Own Expeditions sh.p.k.	0676096010	nancytare@ouroenexpeditions.com	Nivicë, Tepelenë	6
13	Jeton Hida P.F.	0693054121	farmasotira@gmail.com	Ersekë, Korçë	7

Burimi: MTM

